

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit MSc në Arkitekturë

në Universitetin Privat "Albanian University"

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Dr. Loreta Çapeli

PhD. Ledian Bregasi

Loreta Çapeli
Ledian Bregasi

Nëntor / 2017

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit MSc në Arkitekturë
në Universitetin Privat "Albanian University"

	Tabela e të dhënave për programin e studimit	
1	IAL Aplikues:	Universiteti Privat "Albanian University"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Shkresë të MASH Nr. 8981 Prot, datë 27.12.2005
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Me Urdhër Nr. 388, datë 23.07.2010 është akredituar, me kohëzgjatje normale 4 vite (e pasaktë pika 4). Me Urdhër Nr. 445, datë 01.10.2010 është akredituar me kohëzgjatje normale 5 vite (korigjohet pika 4 e Urdhërit të mësipërm për kohëzgjatjen)
5	Titulli i programit të studimit:	Master i Shkencave në Arkitekturë (program i integruar)
6	Cikli i studimit:	Cikli II
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	305 ECTS (*)
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	PO
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	N/A
13	Diplomë e përbashkët/ Diplomë e dyfishitë (shëno emërtimin):	N/A
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
15	Aktivizimi i programit të studimit	Aktivizuar 2005-2006
16	Numri i studentëve:	
	2011-2012	60 studentë në vitin e parë/ 9 studentë të transferuar
	2012-2013	18 studentë në vitin e parë/13 studentë të transferuar
	2013-2014	19 studentë në vitin e parë/13 studentë të transferuar
	2014-2015	20 studentë në vitin e parë/21 studentë të transferuar
	2015-2016	0 studentë në vitin e parë/ 7 studentë të transferuar
	2016-2017	8 studentë në vitin e parë/ 4 studentë të transferuar
	2017-2018	0 studentë në vitin e parë/ 12 studentë të transferuar
(*)	Deklarohet se programi mbështetet në Udhëzimin 15/2008 dhe standardet e cilësisë	

Shënim: Verifikimi ligjor sipas Tabelës më sipër, kryhet nga specialistët e ASCAL që ndjekin këtë vlerësim

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit MSc në Arkitekturë pranë Albanian University

Programi i integruar i studimit të nivelit të dytë Master i Shkencave në "Arkitekturë" i organizuar nga Departamenti i Arkitekturës, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, ka filluar aktivitetin në Tetor të vitit 2005 në bazë të Vendimit të MASH Nr.8981/2, datë 27.12.2005 me titull "Mbi Hapjen e Fakulteteve të Reja në Shkollën e Lartë Jo Publike UFO Dental"

Programi i studimit në Arkitekturë në Shkollën e Lartë universitare private "UFO University" filloi veprimtarinë akademike në 9 tetor 2005.

Programi i studimit ka një kohëzgjatje 5-vjeçare (10 semestra, gjithsej 305 kredite). Në përfundim të programit të studimit të integruar të ciklit të dytë, studentëve u jepet diploma Master i Shkencave në "Arkitekturë".

Programi i studimit është akredituar për here të parë me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 445, datë 01.10.2010.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Dr. Loreta Çapeli
2. PhD. Ledian Bregasi

Gjatë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit u asistuan nga specialistët e ASCAL, R. Qatipi dhe E. Isufaj.

Draft Raporti i Vlerësimit të jashtëm është dërguar në Universitetin Privat "Albanian University" me shkresë Nr 203/11 Prot, datë 20.11.2017 "Dërgohen Draft raportet e vlerësimit të jashtëm". dhe nëpërmjet sistemit AMS.

Institucioni paraqet me shkresë Nr. 319, datë 01.12.2017 "Kthim përgjigje për draft Raportin e programit të studimit Msc në "Arkitekturë", si dhe nëpërmjet sistemit AMS, disa komente dhe sugjerime për Draft Raportin. Ekspertët e vlerësimit të jashtëm nuk i morën parasysh këto sugjerime dhe komente dhe nuk ndryshuan Raportin. I vetmi ndryshim është në faqen 21, në të cilin fjalja e parë e paragrafit u shtua¹.

Pas kësaj faze, Raporti mori formën e tij përfundimtare.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- a) Rektorati i universitetit të marrë masa për të hartuar plane konkrete veprimi sidomos në nivelet e realizimit të kërkimit shkencor, të cilat duhet të jenë të matshme, të monitorueshme dhe objekt i analizave të vazhdueshme;

¹ Ekspertet deklarojnë: U integrua nje informacion shtese prej komenteve te AU por thelbi i konkluzionit te vlersimit nuk ndryshon.

- b) Të krijohet mundësia për kualifikimin e personelit të ri akademik si dhe të krijohen mekanizma të qarta dhe transparentë për mbështetjen dhe financimin e aktiviteteve shkencore, në të gjitha njësitë;
- c) Të pasurohen më tej laboratorët e materialeve të ndërtimit;
- d) Të pasurohet biblioteka me literaturë edhe periodikë në fushën e arkitekturës;
- e) Të shtohen ambientet (përveç 3 ekzistuesve) që pedagogët e brendshëm të punojnë;
- f) Të shtohen përpjekjet dhe vëmëndja për informatizimin e sistemit të të dhënave pranë zyrës së burimeve njerëzore për të lehtësuar në procedurë dhe në kohë marrjen e informacionit, përditësimin e tyre dhe më pas përpunimin;
- g) Në riorganizimin e kurrikulës që Departamenti po realizon për të aplikuar në vitin akademik 2010 - 2011 të kihet parasysh ulja e numrit të provimeve nga 45 në 35 sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. 15 të datës 04.04.2008, ulja e ngarkesës mësimore për studentët sidomos për vitin e 3-të, si dhe përcaktimin e krediteve për praktikën mësimore që në kurrikulën ekzistuese është shpërndarë në javën e 15 të secilit semestër;
- h) Për zhvillimin e kërkimit shkencor do të ishte hapja e këtij të fundit dhe për publikun, në mënyrë që kërkimi shkencor, aq më tepër në një fushë kaq të aplikuar sa arkitektura dhe urbanistika, të ishte më i prekshëm duke angazhuar edhe specialistë që janë jashtë institucionit për të realizuar kërkim shkencor të aplikuar.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) *“Rektorati i universitetit të marrë masa për të hartuar plane konkrete veprimi sidomos në nivelet e realizimit të kërkimit shkencor, të cilat duhet të jenë të matshme, të monitorueshme dhe objekt i analizave të vazhdueshme” është plotësuar pjesërisht.*
 - Është bërë një punë e mirë në drejtim të organizimit të konferencave shkencore në rang Fakulteti, përfshirë këtu edhe dy konferenca për studentët me ambicjen për të patur cikël zhvillimi të përvitshëm;
 - Është krijuar “Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë”, e cila merret edhe me monitorimin e dhe analizën e kërkimit shkencor, por ajo duhet të jetë më aktive. Nga raportet vjetore mbi kerkimin shkencor dhe ecurinë e mesimdhënies, kjo njësi duhet të bëjë analiza të thelluara dhe të rezultojë në kërkesa specifike për financim të kualifikimit profesional të stafit efektiv, duke ja drejtuar këto kërkesa instancave drejtuese të AU.
 - Pjesëmarrja në konferenca e botime shkencore (min. 2/vit) është vendosur si një kusht kontraktual në pajtimin e stafit efektiv apo dhe atij me kontratë.
 - Është krijuar Njësia e projekteve, e cila funksionon pranë Zyrës së kërkimit shkencor dhe në departament. Kjo njësi ka për detyrë të merret me përgatitjen propozimin e projekteve shkencore, veçse deri tani ajo nuk i ka plotësuar pritshmëritë si pasojë e mosangazhimit të duhur të stafit akademik e të arkitektëve.
 - Është ngritur një sistem i referimit vjetor “Mbi punën shkencore të Stafit akademik”, i cili bëhet në fund të vitit akademik përpilohet nga Departamenti dhe arkivohet pranë “Njesisë së brendshme të sigurimit të cilësisë”.
- b) *Të krijohet mundësia për kualifikimin e personelit të ri akademik si dhe të krijohen mekanizma të qarta dhe transparentë për mbështetjen dhe financimin e aktiviteteve shkencore, në të gjitha njësitë është plotësuar pjesërisht.*

- Inisiativa për kualifikim të personelit akademik ka mbetur në kuadrin personal të dëshirës për kualifikim, për rrjedhojë të të cilit 3 pjesëtarë të stafit efektiv janë duke ndjekur ciklin e studimeve në doktoraturë. Ndër to 1 pjesëtarë i është lejuar ndjekja e doktoraturës në Itali, por pa mbështetje financiare nga Departamenti. (ndihmesa e departamentit kufizohet vetëm në favorizim të largimit të tij të përkohshëm për periudha të shkurtra me anë të lejes institucionale të dhënë pa ndërprerë pagëmuje.)
 - Programi i studimit "Master shkencor në Arkitekturë në stafin e tij efektiv PAE ka aktualisht 13 vetë, ndër të cilët vetëm 4 Dr, 0 Prof, 0 Prof.Asoc., ndërsa në Stafin Akademik me Kontratë PAK ka 7 vetë, ndër të cilët 4 janë: 2 Prof. Asoc. dhe 2 Dr.
 - Thënë kështu rezulton se Departamenti i Arkitekturës, i cili është përgjegjës për këtë program, nuk ka propozuar mobilitete për kualifikim stafi dhe nuk ka mundur të influencojë në planet financiare për të rritur fondin për kualifikim stafi.
 - Në zërat Trajnim Safi të AU, ka trajnime në formë leksioni vetëm për aspektin mësimdhënës të procesit mësimor, por duke qenë se studimet në arkitekturë janë të lidhura tërësisht me formimin profesional, ato janë të pamjaftueshme për rritjen e cilësisë së Arkitektit të aktivizuar si mësimdhënës.
 - Departamenti duhet të shfrytëzojë më mirë marrëveshje bashkëpunimit që ka me universitetet e huaja me qëllim që në kuadër të tyre të ngrihen projekte të përbashkëta e me financim të përbashkët, të cilat të mundësojnë një zhvillim të Kurrikulave por sidomos të mundësojnë mobilitete të stafit akademik pranë Fakulteteve në Itali, me qëllim kualifikimin e tyre në aspektin profesional e të mësimdhënies.
- c) *Të pasurohen më tej laboratorët e materialeve të ndërtimit. **është plotësuar** institucioni nuk ka ngritur një laborator materialesh ndërtimi, por ka lidhur kontratë bashkëpunimi me laboratorin Alb-Consult-2 sh.p.k.*
- d) *Të pasurohet biblioteka me literaturë edhe periodikë në fushën e arkitekturës, **është plotësuar pjesërisht.***
- *Biblioteka disponon tashmë mjaft tituj mbi arkitekturën, por duhet të pasurojë fondin e periodikëve nga kjo fushë duke qenë se për momentin nuk ka aktiv ndonjë abonim në periodikë në fushën e arkitekturës.*
- e) *Të shtohen ambientet (përveç 3 ekzistuesve) që pedagogët e brendshëm të punojnë, **është plotësuar** dhe tashmë në Departamentin e Arkitekturës janë 6 zyra të destinuara për Pedagogët.*
- f) *Të shtohen përpjekjet dhe vëmendja për informatizimin e sistemit të të dhënave pranë zyrës së burimeve njerëzore për të lehtësuar në procedurë dhe në kohë marrjen e informacionit, përditësimin e tyre dhe më pas përpunimin, **është plotësuar** dhe tashmë në Zyrën e Burimeve Njerëzore baza e të dhënave është në formë elektronike*
- g) *Në riorganizimin e kurrikulës që Departamenti po realizon për të aplikuar në vitin akademik 2010 - 2011 të kihet parasysh ulja e numrit të provimeve nga 45 në 35 sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. 15 të datës 04.04.2008, ulja e ngarkesës mësimore për studentët sidomos për vitin e 3-të, **nuk është plotësuar**, ndërkohë që: përcaktimi i krediteve për praktikën mësimore që në kurrikulën ekzistuese është shpërndarë në javën e 15 të secilit semestër, **është plotësuar.***
- Ngarkesa mësimore për studentët vazhdon të mbetet e lartë. Në çdo semestër e në çdo vit akademik ka një numër të lartë provimesh si dhe në total një numër të lartë kreditesh (305). Departamenti duhet të rishikojë kurrikulën me qëllim uljen

e numrit të përgjithshëm të krediteve në 300, si dhe vendosjen e një ekuilibri më të mirë midis disiplinave të formimit të përgjithshëm e atyre të formimit karakterizues, në favor të rritjes së peshës së lëndëve të formimit karakterizues.

- Praktika mësimore nuk zhvillohet më në javën e 15-të por është shpërndarë në lëndë të ndryshme dhe kreditet e saj janë përcaktuar në planin mësimor.

*h) Për zhvillimin e kërkimit shkencor do të ishte hapja e këtij të fundit dhe për publikun, në mënyrë që kërkimi shkencor, aq më tepër në një fushë kaq të aplikuar sa arkitektura dhe urbanistika, të ishte më i prekshëm duke angazhuar edhe specialistë që janë jashtë institucionit për të realizuar kërkim shkencor të aplikuar, **është plotësuar***

- Revista OPTIME është e hapur edhe për publikun duke i mundësuar kujdo botime të artikujve shkencorë në të. Institucioni është hapur ndaj praktikës profesionale duke marrë pjesë në një numër projektesh e konkursesh projektimi.

Përfundimi:

Nga rekomandimet e mësipërme më problematiket mbeten ato të lidhura me cilësinë e kualifikimin e stafit akademik, si dhe me sasinë e cilësinë e kërkimit shkencor, rekomandime të cilat janë plotësuar vetëm pjesërisht. Gjithashtu Pasurimi i Bibliotekës me literaturë e periodikë, sekretaria elektronike dhe ulja e ngarkesës në kredite për studentët, nuk janë plotësuar.

Ndërkohë institucioni ka plotësuar disa nga rekomandimet duke shtuar ambientet për personelin akademik, duke siguruar laboratorin për materialet e ndërtimit, duke përcaktuar në plan mësimor kreditet për praktikën mësimore dhe duke informatizuar bazen e të dhënave të zyrës së burimeve njerëzore.

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Albanian University organizon programin e studimeve MSc në Arkitekturë në përputhje me qëllimet dhe objektivat e institucionit.

Këto objektiva shtjellohen nëpërmjet Planit Strategjik të Zhvillimit të Institucionit. Referuar Raportit të vlerësimit të brendshëm institucioni deklaron se:

Ky program ka një kohëzgjatje 5-vjeçare dhe ka si mision parësor përpunimin dhe transmetimin e dijeve, progresin e kulturës, përparimin dhe vlerësimin në fushën e arkitekturës dhe urbanistikës. Departamenti i Arkitekturës synon të krijojë në rrafshin intelektual, etik një lidhshmëri në arkitekturë dhe në urbanistikë nëpërmjet ekselencës në mësimdhënie, kërkimit shkencor në shkollë, praktikës krijuese arkitektonike dhe aktivitetit ndaj komunitetit.

Më në detaj, Departamenti i Arkitekturës ka si objektiv të japë një formim bazë kulturor të mirë, të integruar si dhe një formim profesional të qëndrueshëm. Në këtë mënyrë studentët do të jenë të përgatitur me bazën teorike si dhe metodat për të përballuar kulturën e projektimit arkitektonik; të plotësojnë studentët me njohuri të shumfishta për të qenë në përputhje me kërkesën dhe problemet në rritje ndaj projektimit arkitektonik dhe urbanistik, në përputhje me kërkesat e tregut dhe teknologjisë së ndërtimit. Ky objektiv realizohet nëpërmjet një komunikimi dhe lidhje të ngushtë e të vazhdueshme që ka departamenti me komunitetin profesional dhe studiove të projektimit; të përgatisë studentë të cilët të jenë të aftë të konceptojnë një vepër arkitektonike që plotëson nevojat jetësore, estetike ashtu dhe ato teknike; të përgatisë studentë të cilët të jenë të aftë të mendojnë në mënyrë kritike, shumëdisiplinore duke integruar aftësitë projektuese, profesionale dhe etikën njerëzore; të përgatisë studentë të ndjeshëm ndaj çështjeve të mprehta të kohëve të sotme lidhur me mbrojtjen e mjedisit, arkitekturës dhe urbanistikës së qëndrueshme.

Programi i studimit ka si objektiv të japë me kompetencë teknikat e konstruksionit, të bazuara mbi një njohje të mjaftueshme të metodave konstruktive të arkitekturës; të japë njohuri të mjaftueshme mbi metodat e projektimit arkitektonik e urbanistik, ekologjikisht të qëndrueshëm, me një kujdes mbi ruajtjen dhe vlerësimin e ambientit; të mbajë një përgjegjshmëri dhe ndjeshmëri përballë vlerave humane, sociale, historike, kulturore, urbane, arkitektonike dhe ambientale si dhe ato të trashëgimisë kulturore; të japë një njohje të mjaftueshme të pjesës ekonomike dhe financiare të menaxhimit dhe zbatimit, të kontrollit të kostove si dhe metodat e realizimit të një objekti.

Megjithëse programi organizohet në përputhje me misionin dhe objektivat e institucionit, fakti që vitet e fundit vihet re një rënie e numrit të studentëve, sjell nevojë për një analizë të thellë të lidhur edhe me nevojat e tregut të punës si dhe me zhvillimin ekonomik të vendit. Rezultatet e kësaj analize duhet të bëhen pjesë e rishikimit të objektivave për të ardhmen e programit të studimit.

Emërtimi i programit dhe përmbajtja e tij janë në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Programi i studimit Msc në Arkitekturë është i hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit. Në program janë parashikuar module ku diskutohen dhe analizohen vlerat historike dhe kulturore kombëtare.</p> <p>Megjithatë, vitet e fundit vihet re një rënie e numrit të studentëve dhe në veçanti në vitet akademike 2015-2016 dhe 2017-2018 nuk ka patur regjistrime të reja në vitet e para por vetëm transferime. Ky fakt ka nevojë për një analizë të thellë të lidhur edhe me nevojat e tregut të punës si dhe me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit është në linjë me strategjinë e zhvillimit të institucionit.</p>
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit MSc në Arkitekturë është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Gjithashtu, emërtimi i programit të studimit është në përputhje me kualifikimin e arritur dhe përcaktuar në nivelin e shtatë të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.</p> <p>Kurrikula e programit të studimit është hartuar me 305 ECTS, duke ju përshtatur Udhëzimit 15/2008 i Ministrisë së Arsimit dhe standardeve të cilësisë ku përcaktohet se në këtë cikël duhet të jepet të paktën 300 ECTS. Megjithatë, ngarkesa mësimore për studentët vazhdon të mbetet e lartë. Në çdo semestër e në çdo vit akademik ka një numër të lartë provimesh si dhe në total një numër të lartë kreditesh.</p>
Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Albanian University ka miratuar Planin Strategjik të Zhvillimit Institucional në të cilin diskutohet përmirësimi i programeve të studimit si dhe përmirësimi i rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p> <p>Për sa i përket programit të studimit MSc në</p>

	<p>Arkitekturë, strategjia përcakton si objektiv përmirësimin periodik të programit të studimit por nuk parashikohen masa konkrete për t'u përballur me rënien e numrit të studentëve të rinj të rregjistruar në vitin e parë të programit.</p> <p>Strategjia për promovimin dhe ngritjen e kapaciteteve të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, megjithëse shprehet për nxitjen e thellimit të vazhdueshëm të njohurive dhe të pjesëmarrjes në kërkim shkencor, nuk parashikon masa konkrete për arritjen e këtij objekti.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Albanian University ofron programin e studimit MSc. në Arkitekturë në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit si dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Megjithatë, ngarkesa mësimore për studentët vazhdon të mbetet e lartë. Në çdo semestër e në çdo vit akademik ka një numër të lartë provimesh si dhe në total një numër të lartë kreditesh prej 305 ECTS.</p> <p>Institucioni harton gjithashtu planin strategjik pesëvjeçar për zhvillimin institucional por në të apo në ndonjë dokument tjetër strategjik nuk del në pah analiza e faktorëve që mund të kenë çuar në uljen e numrit të studentëve të rinj të rregjistruar në vitet e para për programin e studimit MSc në Arkitekturë. Pa një analizë të tillë të tregut të punës dhe të kushteve sociale dhe ekonomike të vendit, institucioni rrezikon të mbete në pozita pasive ndaj faktorëve të jashtëm që ndikojnë rregjistrimet e reja dhe të mos jetë në gjendje të hartojë plane strategjike afatmesme ose afatgjata për përmirësimin e programit të studimit.</p> <p>Gjithashtu objektiv për promovimin dhe kualifikimin e personelit akademik nuk përkthehet në masa konkrete nxitëse dhe rrezikon të mbetet në iniciativën dhe vullnetin vetjak të personelit.</p>	

2. Struktura akademike e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit


Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në IAL "Albanian University" ka në përbërje tre departamente:

- Departamenti i Shkencave Ekonomike,
- Departamenti i Arkitekturës
- Departamenti i Inxhinierisë.

Mbështetur në këtë strukturë akademike ofrohen edhe programet e studimit (shih skemën më poshtë)

Departamenti i Arkitekturës është përgjegjës për organizimin e programit të studimit MSc në Arkitekturë. Ky departament është gjithashtu përgjegjës për organizimin e programit BSc në Dizajn dhe për programin PhD në Arkitekturë, i cili nuk është aktivizuar asnjëherë.



Struktura akademike e Fakultetit/Departamentit

Fakulteti. Struktura organizative e Fakultetit përbëhet nga autoritetet drejtuese, organet drejtuese, njësitë bazë të punës mësimore - shkencore dhe nga administrata. Autoritete drejtuese akademike janë Dekani, ZëvendësDekani, Përgjegjësit e departamenteve. Organ drejtues akademik është Asambleja e Personelit Akademik të Fakultetit. Struktura organizative, përbërja, funksionimi dhe të tjera çështje që lidhen me të përcaktohen në rregulloren e fakultetit.

Dekani është autoriteti më i lartë drejtues dhe përfaqësues i Fakultetit. Dekani i Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike është Prof. Asoc. Dr. Remzi Sulo. Dekani koordinon, organizon, drejton, kontrollon dhe përgjigjet për ecurinë e procesit mësimor dhe të kërkimit shkencor në Fakultet. Kompetencat e Dekanit përcaktohen në Rregulloren e Fakultetit.

Asambleja e Personelit Akademik të Fakultetit është organ drejtues kolegjal vendimarrës i cili kryesohet nga Dekani. Ai përbëhet nga anëtarë të stafit akademik, administrativ dhe studentë. Detyra specifike dhe funksionimi i tij përcaktohen në rregulloren e fakultetit.

Historiku i Strukturës së Fakultetit/Departamentit të Arkitekturës:

Me shkresë të MASH Nr. 8981 Prot, datë 27.12.2005 është licencuar Fakulteti i Shkencave të Aplikuara, për ofrimin e programit të Arkitekturës.

Me Urdhër Nr. 196, datë 28.05.2013 të MASH “Riorganizimi i njësive kryesore”, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara, u riorganizua në “Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierive”, me përbërje: Departamenti i Arkitekturës, Departamenti i Elektronikës dhe Qendër kërkimore

Me Urdhër të MASH Nr. 52, datë 05.02.2016 u riorganizua i gjithë Institucionii Universitetit Privat "Albanian University", në tre njësi kryesore. Rrjedhimisht Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierive u riorganizua duke përfshirë në strukturën e tij dhe Departamentin e Shkencave Ekonomike, duke u quajtur "Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike".

Personeli akademik i Departamentit përbëhet nga personel akademik efektiv, personel akademik me kontratë dhe nga personeli administrativ.

Tabelat 2 (shih Anekset) japin përbërjen e Departamentit të Arkitekturës për vitet akademike 2015-2016, 2016-2017 dhe për semestrin e parë të vitit të ri akademik 2017-2018

Pjesa më e madhe e personelit akademik të programit të studimit formohet nga pedagogë efektivë. Pjesa tjetër e stafit akademik përbëhet nga personel akademik me kontratë, të cilët lidhin një kontratë bashkëpunimi me Universitetin. Në kundërshtim të bashkëpunimeve ndërkombëtare me Universitete të huaja pjesë e stafit akademik me kontratë janë dhe pedagogët këtyre Universiteteve. Një pjesë e vogël e stafit akademik zotëron titujt e nevojshëm (profesor, profesor i asociuar, kërkues, doktor shkencash) për të zhvilluar një proces mësimor efikas.

Për periudhën nga 2015 ne tetor 2017, përqindja e pedagogëve me titull (Prof/Prof.asoc/Dr.) ne stafin akademik me kohë të plotë ka qenë 13% për 2015-16, 29% për 2016-17, dhe 33% për 2017-18.

Ndërkohë nga tabelat vihet re se raporti Staf akademik efektiv (PAE) dhe Staf akademik me kontratë ka ndryshuar në tendencën për të rritur qoftë edhe pak numrin e PAE në raport me PAK.

Për vitin akademik 2015-2016 Departamenti i Arkitekturës ka patur në përbërjen e tij 16 anëtar efektivë si personel akademik, ndër të cilët 2 me grada dhe tituj shkencor. Për vitin 2016-17 ka patur 17 PAE, ndër të cilët 5 me tituj/grada. Për vitin 2017-2018 ka 21 anetare efektivë ndër të cilët 7 me tituj/grada.

Pedagogët me kontratë me Albanian University rekrutohen duke pasur parasysh edukimin e tyre akademik brenda apo jashtë vendit.

Personeli administrativ në mbështetje të aktiviteteve akademike përbëhet nga stafi, që lidhet me aspekte të ndryshme ndihmëse ndaj aktivitetit akademik: biblioteka, informatika, infrastruktura kryesore dhe mbështetëse etj.

Vlerësimi sipas standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;	Organizimi i Albanian University lejon përmbushjen e misionit të tij. Institucioni është i organizuar në tre fakultete. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, në strukturën e të cilit organizohet programi i studimit MSc. në Arkitekturë, është i organizuar në tre departamente me misione dhe objektiva të përcaktuara. Departamenti i Arkitekturës, përgjegjës për organizimin e programit të studimitstrukturohet në të njëjtin fakultet së bashku me Departamentin e Shkencave
Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;	
Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;	
Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;	
Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të	

<p>cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>Ekonomike dhe Departamentin e Inxhinierisë.</p> <p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike gjendet para përgjegjësisë për të bashkërenduar mësimdhënien dhe kërkimin shkencor të shumë disiplinave, shpesh të largëta prej njëra tjetrës. Kjo largësi mes disiplinave mund të krijojë vështirësi në nivel organizativ për programin e studimit MSc në Arkitekturë. Gjatë viteve të aktivitetit të programit të studimit MSc në Arkitekturë, njësia përgjegjëse është riorganizuar disa herë.</p> <p>Për vitin akademik 2015-2016 Departamenti i Arkitekturës ka patur në përbërjen e tij 16 anëtar efektivë si personel akademik, ndër të cilët 2 me grada/tituj shkencor. Për vitin 2016-17 ka patur 17, ndër të cilët 5 me tituj/ grada. Per vitin 2017-2018 ka 21 anëtare efektivë ndër të cilët 7 me tituj/ grada</p>
<p>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike angazhohet në mbarëvajtjen e programit të studimit dhe Departamenti i Arkitekturës është përgjegjës për realizimin e programit të studimit.</p> <p>Departamenti harton kërkesat për rekrutim të personelit të ri akademik ndrsa fakulteti miraton listat e kandidatëve të rekrutuar si personel akademik.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Albanian University organizohet në tre fakultete dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara organizohet në tre departamente, ndër të cilët, departamenti i Arkitekturës, përgjegjës për organizimin e programit të studimit.</p> <p>Kombinimi i departamenteve me fusha të ndryshme disiplinore rrezikon të krijojë vështirësi për programin e studimit, parë largësinë e fushave të interesetit të departamenteve së fakulteti përgjegjës për bashkërendimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Per tre vitet e fundit vihet re se raporti Staf akademik efektiv (PAE) dhe Staf akademik me kontratë ka ndryshuar në tendencën për të rritur qoftë edhe pak numrin e PAE në raport me PAK., por mbetet ne perqindje te uleta numri i personelit akademik me tituj shkencore.</p>	

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Albanian University angazhon personelin akademik dhe mbështetës në përputhje me misionin e institucionit. Thirrjet për personel të ri ndodhin në mënyrë transparente dhe institucioni arkivon të dhënat e personelit. Gjatë veprimtarisë së programit të studimit MSc në Arkitekturë janë vënë re periudha ku raporti PAE/PAK, titujt e gradat e personelit akademik si dhe ngarkesa mësimore në orë nuk kanë qenë në përputhje me normat e përcaktuara në aktet nënligjore.

Këto raste shtjellohen në vazhdim.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Shih Tabelat 3 në Anekset)

Përsa i takon pedagogëve si personel akademik efektiv (PAE) për Programin e studimit:

- Për vitin 2015-2016 ka patur 16 pedagoge, ndër të cilët 2 me titull shkencor.
- Për vitin 2016-2017 ka patur 16 pedagogë ndër të cilët 8 me titull shkencor.
- Për vitin 2017-2018 ka 13 pedagogë efektivë ndër të cilët 4 me titull Dr.

Përsa i takon pedagogëve si personel akademik me kontrate (PAK):

- në vitin 2015-2016 ka patur 13, ndër të cilët 8 me titull/grada,
- në vitin 2016-2017 ka patur 12 ndër të cilët 7 me titull/grada,
- në vitin 2017-18 semestri parë ka 7 PAK nga të cilët 4 me titull.

Vihet re që përqindja e pedagogëve me titull është me e madhe tek pedagogët me kohe të pjesshme-kontrate.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (shih Tabelat 3)

Për të tre vitet e fundit, të reflektuara në tabelë, vihet re stafi akademik efektiv (PAE) ka në përputhje një numër relativisht të ulët të pedagogëve me titull shkencor, që nuk i kalon të 33% të numrit të përgjithshëm, ndërkohë që nga pedagogët me kontrate (PAK) ky numër është me i madh duke patur tendencën të jetë deri në 50% apo më tepër.

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit (shih Tabelën 4)

Bazuar në RVB, këshilli shkencor përfaqësohet me katër anëtarë ndër të cilët edhe koordinatori i programit. Njëri prej anëtarëve ka titullin shkencor Profesor.

- Të dhëna sipas moshës dhe sipas seksit, të personelit akademik (shih Tabelat 5)

Nga tabelat e pakta por dhe nga vizita në institucion vihet re se pjesa më e madhe e stafit akademik efektiv (PAE) është në mosha të re, në fashën nga 25-35 vjeç, ndërkohë që nga stafi

akademik me kontrate (PAK), kjo perqindje vjen duke u ulur, e pjesa me e madhe i tekojne fashes 35-45 vjeç apo më shumë.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Bazur në raportin e vlerësimit të brendshëm si dhe në vizitën në institucion marrëdhënia e punës mes të punësuarit dhe universitetit rregullohet sipas legjislacionit në fuqi si dhe sipas Kodit të Punës. Gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve Njerëzore u vunë në dispozicion kopje të kontratave dhe të dokumentacionit të pedagogëve.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Bazuar në vizitën në institucion si dhe në RVB personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit është i angazhuar sipas objektivave të programit të studimit.</p> <p>Angazhimi i këtij personeli ndodh gjithashtu në përputhje me strategjinë institucionale të zhvillimit. Gjatë vizitës në institucion u komunikua me personalin akademik dhe ndihmës mësimor-shkencor ku u diskutua më në detaj angazhimi i tyre në institucion</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik, në rast se është titullar i lëndës luan rol në hartimin dhe përmirësimin e syllabusit.</p> <p>Ndryshimet dhe përmirësimet e dokumentuara kanë të bëjnë në përgjithësi me përditësim të literaturës dhe të mënyrës së vlerësimit.</p> <p>Është e vështirë të vlerësohet roli i personelit akademik në përmirësimin e kurrikulës së programit të studimit pas nuk janë dokumentuar raste të tilla.</p> <p>Bazuar në vizitën në institucion si dhe në RVB rezulton se rekrutimi i personelit të ri bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kjo procedurë u konstatua gjithashtu gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore.</p> <p>Ndërkohe vihen re raste ku ngarkesa mësimore për personelin akademik tejkalon normat.</p>
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.	

<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Albanian University ka përcaktuar procedurën ligjore të rekrutimit të personelit të ri akademik dhe e dokumenton këtë procedure në përputhje me rregulloren e brendëshme.</p> <p>Lajmërimet për pozicione të lira për personel akademik bëhen publike ne media dhe faqen zyrtare ëeb të universitetit. Institucioni mban një bazë të dhënash për këto njoftime si dhe për vendimet e grupeve të vlerësimit të aplikantëve për pozicione të lira për personel akademik.</p> <p>Referuar tabelave të dhëna nga institucioni për ngarkesën e personelit akademik rezulton se: Për vitin akademik 2015-2016, personeli akademik efektiv (PAE) ka mbuluar 69.3 % të ngarkesës në orë të programit të studimit, nderkohe qe ne vitin 2016-17 kane mbuluar 72 % te ngarkeses.</p> <p>Për vitin akademik 2017-2018, insitucioni ka vënë në dispozicion të GVJ ngarkesën në orë të programit për semestrin e parë. Gjatë këtij semestri personeli akademik efektiv mbulon 72.2 % të ngarkesës në orë të programit të studimit.</p> <p>Institucioni bën një vlerësim të personelit akademik të bazuar në anketimet e studentëve si dhe në një raport vlerësimi të hartuar nga drejtuesi i departamentit.</p> <p>Megjithëse këto vlerësime i behen të ditura personelit akademik në mënyrë transparente, nuk është e qartë metodologjia dhe teknika e përdorur nga drejtuesi i departamentit në vlerësimin e personelit akademik.</p> <p>Nuk është gjithashtu e qartë pesha specifike e secilit komponent të vlerësimit të performancës si për shembull në rastin e vlerësimit të kërkimit shkencor.</p>
---	--

Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin</p>	<p>Përgjegjësi i Departamentit të Arkitekturës mban titullin Profesor i Asociuar ndërsa përgjegjësjë e programit të studimit MSc në Arkitekturë nuk ka gradën shkencore doktor por ka fillua programin e doktoratës pranë një universiteti europian.</p> <p>Në dokumentacionin bashkangjitur Raportit të Vlerësimit të Brendshëm për vitin akademik 2016-2017 vihet re se 50% e titullarëve të lëndëve dhe moduleve të programit të studimit</p>
--	--

<p>në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>nuk e kanë të paktën gradën shkencore Doktor. Nga 26 titullarë, 7 ishin në proces të studimeve të doktoratës dhe 6 me diplomë MSc.</p> <p>Ndërkohë që në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në institucion për semestrin e parë të vitit akademik 2017-2018 u vu re që të gjithë titullarët e lëndëve kanë të paktën gradën shkencore Doktor. Në këtë kuadër vihet re ndryshim i shpeshtë i titullarëve dhe lektorëve të lëndëve, fakt i cili mund të ndikojë në mënyrë negative në garantimin e vazhdimësisë së programit të ofruar studentëve, sidomos për programe studimi si Arkitektura ku një përqindje e madhe e lëndëve të projektimit bazohen në marrëdhënien personale mes pedagogut dhe studentit. Ka raste ku titullari i lëndës nuk është më pjesë e personelit akademik të institucionit</p> <p>Rektorja, zv/rektorja, dekani, përgjegjësi i departamentit dhe përgjegjësjë e programit të studimit janë të punësuar me kohë të plotë në Albanian University.</p>
---	---

Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.

<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore "Doktor";</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Studentëve të vitit të pestë, në fillim të semestrit të dytë u caktohet nga departamenti udhëheqës për temën e diplomës.</p> <p>Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore Doktor dhe nuk ndjek më shumë se 5 studentë njëkohësisht.</p>
---	---

Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.

<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, përgjegjësi i departamentit dhe koordinatorja e programit të studimit vunë në dispozicion punët e diplomës së studentëve. U vu re se udhëheqësi i temës së diplomës është i specializuar në fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Tezat e diplomave hartohen gjithashtu në përputhje me fushën studimore-kërkimore të</p>
---	---

	udhëheqësit.
Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Personeli ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohet me synim përmbushjen e misionit të institucionit.</p> <p>Vihen re raste kur personeli akademik është i mbingarkuar krahasuar normave në fuqi, fakt që mund të ndikojë negativisht në përmbushjen e objektivave të programit. Në takimet në institucion u vu re se pjesë e personelit kryen edhe detyra administrative.</p>
Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Personeli akademik e realizon ngarkesën mësimore e cila vlerësohet me orë mësimore.</p> <p>Vihen re se personeli akademik është i ngarkuar përtej normave të përcaktuara në Udhëzimin Nr. 20, datë 9.5.2008 të MASH.</p> <p>Pas vizitës në institucion, Albanian University vuri në dispozicion tabela të përditësuara të ngarkesës së personelit akademik për vitet 2016-2017 dhe për semestrin e parë të vitit akademik 2017-2018. Për vitin akademik 2016-2017 vihen re këto mbingarkesa për personelin akademik:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Drejtuesi i departamentit të arkitekturës ka një ngarkesë prej 300 orësh në vend të kufirit prej 170 orësh. - Drejtuesi i departamentit të inxhinierive, i angazhuar në mësimdhënie në programin MSC në Arkitekturë, ka një ngarkesë prej 522.5 orësh, tre herë më i lartë se kufiri prej 170 orësh. - Dy pedagogë me gradën shkencore Doktor kanë ngarkesë me të lartë se kufiri prej 260 orësh. <p>Për vitin akademik 2017-2018 janë vënë në dispozicion programi mësimor dhe ngarkesa mësimore vetëm për semestrin e parë kështu që është e pamundur të vlerësohet ngarkesa për vitin e plotë akademik.</p> <p>Një numër i madh i statistikave të përpunuara nga institucioni hartohen në bazë semestri. Kjo praktikë krijon vështirësi në matjen dhe garantimin e cilësisë së kërkuar për sa i përket nivelit të kualifikimit të personelit, ngarkesës dhe raporteve të tjera.</p>

Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;

Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;

Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.

Albanian University disponon një bazë të dhënash dhe dosje individuale për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në programin e studimit. Ky informacion është i organizuar edhe në bazë semestri.

Lajmërimet për pozicione të lira për personel akademik si dhe kriteret dhe procedura e rekrutimit bëhen publike në media dhe faqen zyrtare të universitetit.

Konkluzionet e vlerësimit:

Personeli akademik në programin e studimit MSc. në Arkitekturë rekrutohet me procedurë transparente dhe zyra e burimeve njerëzore organizon dhe drejton bazën e të dhënave.

Personeli akademik merr pjesë në hartimin dhe rishikimin e syllabuseve, por nuk mund të vlerësohet kontributi i personelit akademik në hartimin dhe rishimin e kurrikulës mësimore.

Raporti mes ngarkesës në orë mësimore të personelit akademik efektiv dhe atij me kontratë ka ndryshuar vazhdimisht gjatë cdo semestri. Për vitin akademik 2015-2016, personeli akademik efektiv ka mbuluar 69.3 % të ngarkesës në orë të programit të studimit. Në vitin akademik 2016-2017 ka mbuluar 72% dhe në semestrin e parë të vitit akademik 2017-2018 është 72.2%.

Vlerësimi i performances së personelit akademik ndodh nga anketimet e studentëve dhe nga vlerësimi i përgjegjës të departamentit. Nuk është e qartë metodologjia e vlerësimit nga ana e përgjegjës të departamentit si dhe pesha specifike në vlerësim e secilit përbërës. Në këtë mënyrë vlerësimi rrezikon të mbetet subjektiv.

Drejtuesit e institucionit dhe të departamentit kanë grada dhe tituj shkencorë, por përgjegjësja e programit të studimit nuk mban grade shkencore doktor por është e rregjistruar në këtë moment në një program doktore.

50% e titullarëve të lëndëve nuk kanë patur të paktën gradën shkencore doctor gjatë vitit akademik 2016-2017, ndërsa gjatë semestrit të parë të vitit akademik 2017-2018 të gjithë titullarët e lëndës kanë të paktën gradën shkencore doktor. Pavarësisht mbulimit të të gjitha lëndëve me titullarë me grade shkencore, gjatë semestrit të parë të vitit akademik 2017-2018, ndryshimi i shpeshtë i titullarëve të lëndëve mund të krijojë vështirësi sidomos për lëndët e projektimit, ku marrëdhënia mes studentit dhe pedagogut është thelbësore.

Vihet re se personeli akademik është i ngarkuar përtej normave. Gjatë vitit akademik 2016-2017 vihet re se drejtuesi i departamentit të arkitekturës ka një ngarkesë prej 300 orësh në vend të kufirit prej 170 orësh; Drejtuesi i departamentit të inxhinierive, i angazhuar në mësimdhënie në programin MSc në Arkitekturë, ka një ngarkesë prej 522.5 orësh, tre herë më i lartë se kufiri prej 170 orësh dhe dy pedagogë me gradën shkencore Doktor kanë ngarkesë me të lartë se kufiri prej 260 orësh.

Një numër i madh i statistikave të përpunuara nga institucioni hartohen në bazë semestri. Kjo praktikë krijon vështirësi në matjen dhe në garantimin e cilësisë së kërkuar për sa i përket nivelit të kualifikimit të personeli ngarkesës dhe raporteve të tjera.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Programi i studimit MSc në Arkitekturë zhvillohet në selinë e Albanian University në rrugën e Kavajës. Në këtë ndërtesë ndodhen mjediset mësimore, zyrat administrative dhe të pedagogëve, biblioteka dhe labororet informatike si dhe atelier vizatimit. Ndërtesa nuk është e aksesueshme nga persona me vështirësi në lëvizje dhe në të ndodhet vetëm një shkallë e brendëshme.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit, mbështetur në RVB dhe vizitën në institucion:

	Mjediset e Fakultetit, në funksion të programit të studimit	Sasia	m²
1	Salla për leksione	5	341
2	Klasa për seminare	8	295
3	Salla për aktivitete promovuese	1	60
4	Salla për praktikë lëndore/ profesionale	2	190
5	Laboratorë për lëndët informatike	1	55
6	Salla interneti, Salla për bibliotekë	1	31
7	Mjedis për fotokopjime, librari etj	1	8.8
8	Zyrë informacioni për studentët	1	6
9	Korridore/holle	11	645
10	Mjedise per arkivat	2	46
11	Mjedise Higjeno sanitare	5	51
12	Mjedise per qeverine studentore	1	31
13	Mjedise shlodhese/kafene (per te trete)	1	125
14	Norma per student	4.1 m ² /studentë	

Shënim: Në përlogaritje janë marrë në konsideratë dhe numri i studentëve të programeve të studimit të Inxhinierive dhe Dizajnit.

Mjediset për stafin akademik te Fakultetit:

	Mjediset per stafin e Fakultetit, në funksion të programit të studimit	Sasia	m²
1	Mjedise për Dekanin/ kancelarin	1	23
2	Zyra për sekretarinë mësimore	1	35
3	Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore	2	25
4	Zyra per financen	2	47
5	Zyre per NJBSC	1	23
6	Salla per mbledhje	3	71
7	Mjedise te stafit te sherbimit	2	5
8	Zyra për personelin akademik	3	71
9	Mjedise Higjeno sanitare	1	16
10	Normativa	7.7 m ² /person	

Mjediset e fakultetit në funksion të programitë studimit janë 4.1 m²/studentë. Kjo vlerë është më e ulët se norma prej 5 m²/studentë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Albanian University, për programin MSc në Arkitekturë ka vendodhje të përhershme ku bëjnë pjesë mjedise administrative si dhe mësimore. Pavarësisht se institucioni gjendet në më shumë se një ndërtesë, programi i studimit zhvillohet vetëm në njërin prej tyre.</p> <p>Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për 10 vjetë. Në këto mjedise gjenden edhe atelierë dhe laboratore kompiuterike.</p> <p>Vihet re se Mjediset e fakultetit në funksion të programit të studimit janë 4.1 m²/studentë. Kjo vlerë është më e ulët se norma prej 5m²/studentë.</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion tekste mësimore dhe në mungesë të tyre, për lëndë të vecatë sigurohet material ndihmës. Gjatë vizitës në bibliotekë u vu re se për këto lëndë janë vënë në dispozicion leksione të shkruara dhe slide të leksioneve.</p> <p>Biblioteka për fushën e arkitekturës nuk është e pasur por garanton një nivel bazë literature. Në të gjendet librari elektronike dhe botime periodike por për momentin nuk ka asnjë abonim aktiv në periodik të fushës së arkitekturës. Në këtë kuadër grupit të vlerësimit të jashtëm nuk i është vënë në dispozicion një plan i detajuar dhe buxhet për shtimin e titujve. Oraret e bibliotekës janë të përshtatura me zhvillimin e programit të studimit.</p>
Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.	

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Albanian University ka në dispozicion klasa, zyra, studio dhe laboratorë informatike të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit.</p> <p>Mjediset mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie por ndërtesa 5 katëshe nuk ka në përdorim ashensorë.</p> <p>Gjithashtu janë shumë të shpeshta barrierat arkitektonike si dhe lartësitë e ulta e jashtë standarteve të disa ambienteve. Këto kushte nuk e bejnë të aksesueshëm ambientin për persona me vshtirësi në lëvizje. Ndërtesa ka në përdorim vetëm një shkallë të brendëshme.</p> <p>Për sa i përket laboratoreve, institucioni ka vënë në dispozicion të grupit të vlerësimit të jashtëm vetëm një marrëveshje bashkëpunimi me një laborator materialesh.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Programi i studimit MSc në Arkitekturë zhvillohet në një seli të përherëshme ku vihen në dispozicion klasa, zyra, studio dhe laboratorë informatike për realizimin e programit të studimit por këto ambiente nuk janë të aksesueshme për persona me vështirësi në lëvizje.</p> <p>Programi i studimit ka në dispozicion laboratorë informatike, dy salla/atelier vizatimi e kompozimi dhe një marrëveshje bashkëpunimi me një laborator materialesh dhe mungojnë laboratorë të tjerë tematikë.</p> <p>Bibloteka e programit të arkitekturës nuk është e pasur por garanton një nivel bazë literature. Në të gjendet librari elektronike dhe botime periodike por për momentin nuk ka asnjë abonim aktiv në periodik të fushës së arkitekturës.</p> <p>Vihet re se Mjediset e fakultetit në funksion të programit të studimit janë 4.1 m²/studentë. Kjo vlerë është më e ulët se norma prej 5m²/studentë.</p>	

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Burimi i vetëm i financimit për programin e studimit janë tarifatat për dhe gjatë studimit. Programi i studimit nuk arrin të gjenerojë të ardhura nëpërmjet granteve për kërkim ose konsulencës. Nëse marrim në konsideratë ardhurat dhe shpenzimet e vetëm një viti akademik (2016 – 2017) dhe për programin e studimit MSc në arkitekturë si dhe numrin e studentëve që frekuentojnë në po atë vit akademik, kostoja për student është 199'508 lekë. Kjo llogaritje mund të kryhej me ato të dhëna të vëna në dispozicion nga RVB, gjithësesi kjo nuk është e vetmja mënyrë për llogaritje e koston për student.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Grantet për kërkim 0 %
- Konsulencat, shërbimet 0%
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit 100%
- Sponsorizimet 0%
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) 0%
- Donacionet, aktivitetet sigurorese, fondacione etj 0%
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) 0%

Programi i studimit financohet krejtësisht prej tarifave të shkollimit dhe nuk mund të mbështetet në burime të tjera.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Bazuar në deklarin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, institucioni kryen një auditim të përvitshëm nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar për situatën financiare, e cila bëhet mbi bilancin e çdo viti kalendarik.</p> <p>Sipas RVB, në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet dhe të ardhurat (duke ju referuar bilancit). Ky raport përmban një pasqyrë të hollësishme referuar bilancit për të ardhurat dhe shpenzimet.</p> <p>Në RVB theksohet se aktualisht universiteti nuk përfiton asnjë grant të huaj që përfitohet nga kontratat e shërbimeve.</p> <p>Komenti juaj Ky fakt e mban institucionin të varur vetëm nga të ardhurat prej studentëve dhe nuk lejon që të jetë konkures në programe financimi të huaja.</p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e</p>	<p>Programi i studimit MSc në Arkitekturë ka vetëm një burim të ardhurash prej tarifave të shkollimit të studentëve.</p> <p>Gjatë shtatë viteve të fundit këto të ardhura kanë pësuar ndryshime të thella me një diferencë prej 500% mes dy vlerave ekstreme. Varësia nga një burim i vetëm të ardhurash, i jashtëm dhe i paqëndrueshëm, duke patur</p>

të ardhurave në të ardhmen.	parasysh edhe numrin e ulët të rregjistrimeve të reja gjatë tre viteve të fundit, e bën programin e studimit të rrezikuar financiarisht dhe e bën të vështirë hartimin e planeve financiare për të ardhmen.
-----------------------------	---

Konkluzionet e vlerësimit:

Bazuar në deklarinimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, institucioni kryen një auditim të përvitshëm nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar për situatën financiare, e cila bëhet mbi bilancin e çdo viti kalendarik. Në këtë raport paraqiten të gjitha detyrimet dhe të ardhurat ku vihet re se aktualisht universiteti nuk përfiton asnjë grant të huaj që përfitohet nga kontratat e shërbimeve.

Varësia nga një burim i vetëm të ardhurash, i jashtëm dhe i paqendrueshëm, duke patur parasysh edhe numrin e ulët të rregjistrimeve të reja gjatë tre viteve të fundit, e bën programin e studimit të rrezikuar financiarisht dhe e bën të vështirë hartimin e planeve financiare për të ardhmen.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë funksionon me emërtime të ndryshme në Albanian University prej vitit 2009. Funksionimi i kësaj njësie parashikohet në statutin e universitetit si dhe në rregulloren e brendëshme të universitetit. NjSBC kryen 2 anketime me studentët në vit, në fund të çdo semestri. 36% e numrit total të studentëve i përgjigjen anketimit dhe të gjitha përgjigjet përpunohen. Nuk janë dokumentuar raste të hapave të mëtejshme të marra në rast konstatimi problemesh ose shqetësimesh.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
 - Sa anketime kanë bërë me studentët:
 - Sa studentë janë anketuar:
 - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
 - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm, etj

Institucioni kryen 2 anketime në vit dhe bazuar në RVB, janë anketuar 36% e studentëve. Të gjitha anketimet përpunohen por nuk janë dokumentuar raste të hapave të mëtejshme të marra në rast konstatimi problemesh ose shqetësimesh. Megjithëse NJSBC kryen monitorime deri në nivel departamenti nuk dokumentonhen raste ku gjetjet e NJSBC përdoren për të kryer ndryshime apo përmirësime të programit të studimit.

- Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Monitorimi i NJSBC kryen deri në nivel departamenti nuk dokumentohen raste ku gjetjet e NJSBC përdoren për të kryer ndryshime apo përmirësime të programit të studimit.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Nuk vihen re masa apo politika konkrete të propozuara nga NJSBC mbi bazën e gjetjeve prej vetëvlerësimeve periodike.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuar me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; Etj. 	<p>Institucioni përdor disametoda vlerësimi për ecurisë së programit të studimit. Metodatat e përdorura janë të drjetëpërdrejta si: rezultatet e arritura nga studentët në detyra, provime e dorëzime, dhe të tërthorta si: sondazhe dhe intervista me studentët.</p> <p>Performanca e pedagogut vlerësohet nëpërmjet anketimeve me studentët si dhe me anë të një vlerësimi që përgjegjesi i departamentit harton në fund të çdo semestri.</p> <p>Nuk është e qartë mbi bazë të cilave kriteret e harton përgjegjësi i departamentit raportin individual për personelin akademik dhe ky fakt rrezikon të lejojë hapësira për vlerësime subjektive.</p> <p>Gjithashtu aktivitetet e kërkimit shkencor, megjithëse deklarohen, nuk marrin vlerësim të cilësisë por mbeten vetëm raportime sasiore.</p> <p>Rezultatet e vlerësimeve përdoren nga institucioni për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Këto rezultate bëhen publike në raporte dhe nivele të ndryshme të institucionit.</p>
Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Të dhëna nga vlerësimi i brendshëm publikohen në broshurat periodike të publikuara nga institucioni. Këto të dhëna janë të arritshme edhe nëpërmjet faqes eeb të institucionit.</p>
Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	

<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Institucioni harton në nivele të ndryshme të tijë analiza vjetore për ecurinë e programit. Duke patur parasysh rënien e numrit të studentëve të regjistruar vitet e fundit në programin e studimit MSc në Arkitekturë, nuk është e qartë cilat janë politikat që synojë përmirësimin e programit të studimit.</p>
--	--

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Albanian University është akredituar në nivel institucional me Vendim BA Nr. 90, datë 20.10.2017.</p> <p>Institucioni përdor si udhëzues për hartimin e instrumenteve për sigurimin e cilësisë manualin e sigurimit të brendshëm të cilësisë së bashku me standardet e miratuara nga APAAL.</p> <p>Institucioni ndjek politikën e vlerësimit periodik vjetor të programeve të studimit nëpërmjet raporteve të vlerësimit dhe pyetësorëve semestral.</p> <p>Programi i studimit shqyrtohet, miratohet dhe mbikëqyret nëpërmjet mekanizmave formalë të shprehura në statut dhe në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Personeli dhe studentët që ndjekin programin e studimit ndërgjegjësohen për rëndësinë e sigurimit të cilësisë.</p> <p>Nevoja për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë shprehet në nivel strategjie dhe objektivash por nuk përkthehet në politika, programe apo masa konkrete.</p>
---	--

Konkluzionet e vlerësimit:

Institucioni përdor metoda të drejtëpërdrejta dhe të tërthorta vlerësimi për ecurisë së programit të studimit. Rezultatet e vlerësimit publikohen në nivele të ndryshme dhe bëhen objekt diskutimi duke filluar nga niveli i departamentit.

Mbetet gjithësesi e paqartë mbi bazë të cilave kritere e harton përgjegjësi i departamentit raportin individual për personelin akademik dhe ky fakt rrezikon të lejojë hapësira për vlerësime subjektive.

Gjithashtu aktivitetet e kërkimit shkencor, megjithëse deklarohen, nuk marrin vlerësim të cilësisë por mbeten vetëm raportime sasiore. Nevoja për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë shprehet në nivel strategjie dhe objektivash por nuk përkthehet në politika, programe apo masa konkrete.

Duke patur parasysh rënien e numrit të studentëve të regjistruar vitet e fundit në programin e studimit MSc në Arkitekturë, nuk është e qartë cilat janë politikat që synojë përmirësimin e programit të studimit. Gjithashtu nuk janë dokumentuar raste të hapave të mëtejshme të marra në rast konstatimi problemesh ose shqetësimesh nga ana e NJSBC.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i studimit Msc në Arkitekturë ka një kohëzgjatje 5-vjeçare (10 semestra, gjithsej 305 kredite) dhe ka si mision parësor përpunimin dhe transmetimin e dijeve, progresin e kulturës, përparimin dhe vlerësimin në fushën e arkitekturës dhe urbanistikës.

Kurrikula e programin e studimit Master i Shkencave në "Arkitekturë" përputhet me misionin dhe qëllimin që i ka vënë vetes Universiteti për përgatitjen e Arkitektëve të ardhshëm. Ajo mban parasysh kërkesat e Kartës së Bolonjës dhe mundohet t'i përmbushë ato. Kurrikulat e Programit të studimit janë ndërtuar mbi bazën e Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS), për një total prej 305 kredite formuese.

Leksionet, seminarët dhe praktikat zhvillohen në auditoret e Albanian University. Është respektuar norma ku një kredit është i barabartë me 25 orë mësimore. Një orë në auditor është e barabartë me 60 minuta. Në përfundim të ciklit të programit të studimit është parashikuar dorëzimi dhe mbrojtja e diplomës, me 30 Kredite (ECTS).

Studentët që përfundojnë programin e studimit Master i Shkencave në "Arkitekturë" në "Albanian University" janë të aftë të punojnë në institucionet krijuese, projektuese dhe zbatuese, por edhe të vazhdojnë studime të mëtejshme në programe të të njëjtit lloj apo të ngjashme edhe jashtë vendit. Pas dplomimit ata mund të ndjekin edhe studime në ciklin e tretë të studimeve – Doktoraturë, pasi të kenë kaluar edhe kushte të tjera që vendos ky cikël.

Në raportin e vlerësimit të brendshëm, institucioni deklaron se:

Kurrikula së programit të studimit është në kohezion me shkollat perëndimore të këtij profili dhe është ndërtuar duke marrë në konsideratë dhe përvojën e suksesshme të Fakulteteve të Universitetit Politeknik të Tiranës. Për përgatitjen e tij janë konsultuar kurrikulat e Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës të Universitetit Politeknik të Tiranës si dhe të programeve përkatëse të Torinos, Milanos, Barit e Pizës.

Këto ngjashmëri hasen gjatë shqyrtimit të vëmendshëm të planeve mësimore, të cilët përdorin të njëjtat emërtime të sylabuseve apo të sasisë së ECTS-ve.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i integruar i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Arkitekturë" ka filluar aktivitetin në muajin Tetor të vitit 2005 në bazë të miratimit të programit të studimit nga MASH me Vendimin Nr. 8981/2, datë 27.12.2005 me titull "Mbi Hapjen e Fakulteteve të Reja në Shkollën e Lartë Jo Publike UFO Dental".

Fillimisht, Struktura që ofronte këtë Program ishte Fakulteti i Arkitekturës, ndërkohë që tani ai ofrohet nga Departamenti i Arkitekturës i Fakultetit të shkencave të Aplikuara. Mendojmë se ky dobësim struktural nuk influencon pozitivisht në ecurinë por sidomos edhe në cilësinë e Programit mësimor.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.) Ky program ka një kohëzgjatje 5-vjeçare (10 semestra, gjithsej 305 kredite)

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- 1 ECTS 25 orë mësimore punë të studentit
- 1 orë mësimore 60'

Ngarkesa e punës së studentëve vlerësohet me kredite ECTS, përkatësisht:

- 60 kredite viti i parë;
- 62 kredite viti i dytë;
- 61 kredite viti i tretë;
- 60 kredite viti i katërt
- 62 kredite viti i pestë

Në Planin mësimor jepet ndarja e ECTS (shih Tabelën 8, ne Aneks) sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Në ndërtimin e Planit Mësimor-Kurrikulës është bërë kujdes që të ruhet raporti i lëndëve të formimit të përgjithshëm, formimit karakterizues të programit dhe të formimit të specialitetit. Kështu:

- Lëndët e formimit të përgjithshëm përbëjnë 19,6 % të kurrikulës, duke respektuar kështu parametrat (brenda 20%) për këtë raport. Mendojmë se do të ishte me vend zvogëlimi i krediteve për lëndët Matematikë 1 dhe Matematikë 2 (nga 5 në 3 ECTS), për lëndët Material Ndërtimi 1 dhe 2 (nga 4 në 3 ECTS), si dhe për kurset e integruar të Shkencë Konstruksioni 1 dhe 2, (përkatësisht nga 8 në 6 ECTS), në favor të uljes së numrit total të krediteve nga 305 në 300, ose në favor të shtimit të krediteve në ndonjë lëndë të rëndësishme profesionale si *Vizatim i Lirë e Gjeometri deskriptive*, apo dhe vendosjes së një lënde *Shkrim Akademik e Kërkim Shkencor*. (Referoju tabelës 8)
- Lëndëve karakterizuese (te mirëfillta profesionale) i jepen më shumë kredite, duke përbërë 55%, por kjo përqindje mund të rritet nëse si lëndë në shërbim të formimit karakterizues profesional mund të futej edhe *Historia e arkitekturës Shqiptare e Bashkëkohore, Teori dhe Kritikë Arkitektonike dhe Restaurim arkitektonik*. (Referoju Tabelës 7).
- Renditja e disiplinave nga një semestër në tjetrin është me lidhje logjike në mënyrë që njohuritë nga fillestare të vijnë në rritje, dhe njohuritë të transmetohen e shfrytëzohen nga lëndët formuese pasardhëse.
- Vihen re lëndë (si *Elemente Projektimi 1 e 2, CAAD 2D* apo *CAAD 3D*) në të cilat nuk ka kredite për Leksione, por kreditet janë të shpërndara vetëm në orë praktike apo Laborator, një faktor negativ ky që cënon cilësinë e sasinë e njohurive që studenti duhet të fitojë.
- Ngarkesa javore dhe ajo semestrale janë në raporte shifrore të pranueshme.
- Ka vend për të bërë ndryshime me qëllim uljen e ngarkesës së provimeve për secilin semestër.
- Në kurrikul kryerja e temës së diplomës ka kohën e përshtatshme dhe të mjaftueshme, në semestrin e dytë të vitit të 5 të studimit.

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit, është si më poshtë:
- Për leksionet 6-12 orë në auditor dhe 19-13 orë punë e pavarur e studentit
 - Për Seminaret 6-8 orë në auditor dhe 19-17 orë punë e pavarur e studentit
 - Për Laboraret 18-25 orë në auditor dhe 7-0 orë punë e pavarur e studentit
 - Për Praktikat lëndore: janë përfshirë në orët e laboratoreve
 - Provimi përfundimtar: 5 orë në auditor dhe 20 orë punë e pavarur e studentit
- Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (shih Tabelat 7, 8 dhe 9)

Plani mësimor i ofruar nga IAL është ai i vitit 2010 (shih Tabelën 7) dhe është aktualisht kurrikula e Programit Master Shkencor në Arkitekturë. Ky Program studimi u hap në vitin 2005 dhe në Kurrikulën e liçencuar në atë vit, kreditet, orët leksione dhe ato praktike, paraqiten në një tabelë me zëra të ndryshëm nga ato të Kurrikulës aktuale. Për pasojë vështirësohet krahasimi zë për zë këto dy kurrikula, por mund të bëhet krahasimi i numrit të krediteve dhe orëve leksion e praktikë (seminar, laborator, praktikë) për secilën lëndë, për të arritur të krijohet kuadri i plotë i ndryshimeve në kohë (nga viti 2005 e sot), mundësisht të shprehura edhe në përqindje.

Sipas anëtarëve të departamentit plani aktual (Tabela 8), është ai i vitit 2010 që ka fare pak ndryshime nga ai i liçencuari, dhe nëse ka patur ato kanë qenë brenda normës 20% që lejon ligji.

Ndërkohë nga analiza krahasuese e dy Kurrikulave del tendenca për të rritur kredite të lëndëve të formimit të përgjithshëm (Matematikë, Materiale ndërtimi, Teknologji arkitekture 1, 2) edhe në mënyre të tepruar me 33%, apo me 25% (referoju Tab. 8) apo për të ulur kreditet në lëndë të formimit karakterizues si Kompozim Arkitektonik ndryshuar me 40% (nga 10 kredite, është bërë 6 kredite) dhe Projektim arkitektonik 1, 2, 3, me 14% (nga 35 kredite, është bërë 30 kredite), gjë që duket e pa arsyeshme brenda një kurrikule të një programi studimi në Arkitekturë.

Gjithashtu vlerësohet si i papërshtatshëm ndryshimi që lënda Restaurim Arkitektonik, nga lëndë e detyruar, kthehet në lëndë me zgjedhje, duke zbehur rëndësinë e këtij aspekti të domosdoshëm në formimin të arkitektit.

- Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (shih Tabelën 10)

Nga të dhënat e Tabelës 10, vemë re se në kohëzgjatjen 2010-2017, stafi mësimdhënës i aktivizuar në një pjesë të mirë të lëndëve është i shumtë në numër (4-6 pedagogë), ndërkohë që shumica ose edhe të gjithë prej tyre janë të larguar (nuk janë më pjesë e stafit mësimdhënës). Ky fakt bëhet domethënës nëse e interpretojmë si një mungesë konsekuente e vazhdimësie në trajtimin e lëndës, gjë që mund të ketë sjellë mangësi didaktike të reflektuara pse jo, edhe në rënien e vazhdueshme të numrit të studentëve që regjistrohen në këtë Program. I takon stafit drejtues të departamentit e të Fakultetit të gjejë mënyrat për të shmangur e kundërshtuar këto lëvizje e largime të shpeshta e të ngrejë strategji e politika që duhet të sigurojnë vazhdueshmërinë e procesit didaktik të Programit.

Gjithashtu duhet të theksojmë se në disa lëndë pedagogët janë vetëm PAK (pedagogë të jashtëm) si për leksionet edhe për orët praktike. Pavarësisht se raporti PAE/PAK është sipas standarteve ligjore, do të ishte e këshillueshme që të paktën njëri nga pedagogët në secilën lëndë, të jetë staf PAE. (Mospasja në çdo Lëndë e të paktën të njërit prej pedagogëve PAE, (pedagogë të brendshëm) brenda stafit mësimdhënës, mund të çojë në uljen e cilësisë së frekuentimit e të realizimit të Lëndës e për pasojë në uljen e cilësisë së përgatitjes të Studentëve).

Faktor tjetër që vihet re në tabelë, është edhe fakti që shpesh, personat e larguar janë pedagogët me titull shkencor e për pasojë stafi mësimdhënës nuk plotëson kushtin e kualifikimit shkencor të domosdoshëm në mësimdhënie.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Syllabuset janë formuluar përmbajtur e reflektuar të dhënat e domosdoshme.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën.
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve. Në formulimin e syllabuseve duhet treguar më shumë seriozitet, për të shmangur paqartësitë e pasaktësitë:

1. Mungojnë të dhënat për vitin mësimor të cilit i takon syllabusi përkatës.
2. Ka pasaktësi në emrat e stafit akademik të aktivizuar në mësimdhënie (figurojnë emra të personave që nuk janë të aktivizuar apo që nuk janë më staf mësimdhënës); apo në emrat e shefit të departamentit që aprovon Syllabusin (ekziston herë një emër e herë një tjetër). Kjo tregon mungesë të azhurnimit të Syllabuseve për çdo vit akademik.
3. Ka mbivendosje të literaturës (e njëjta Literaturë) në syllabuse të ndryshëm. (vizatim i lire 1, 2 dhe elemente projektimi 1,2).
4. Në temat e trajtuara në secilën orë të lëksionit e seminarit: në disa Syllabuse vihen re se temat e orëve seminar nuk koinçidojnë me ato të orëve leksion, duke u planifikuar të zhvillohen në javët para se të shpjegohet tema përkatëse ose në të njëjtën javë me të. (elemente projektimi 2, matematikë 1, material ndërtimi, CAAD). Gjatë vizitës në IAL, u kërkua orari mësimor për 2016-2017, në të cilin u pa se shpesh orët e lëksionit e të seminarit vendosen në të njëjtën ditë, duke e vështirësuar eficientë në funksionimin normal të orës praktike. (Referoju orarit mësimor 2016-2017)
5. Mungon shpjegimi i metodologjisë me të cilën zhvillohen orët e seminarit, praktikës e laboratorit, si dhe shpjegimi i detyrës apo i projektit të kursit përkatës.

Dokumentacioni përkatës, i marrë në institucion

Gjatë vizitës në institucion u diskutua në departament në lidhje me syllabuset, planin mësimor e pedagogët që mbulonin mësimdhënien në lëndët e programit. U morën syllabuset e vitit akademik 2017-18 të cilat paraqesin probleme në përpilim, të njëjta me ato të deklaruara në RVB. e të parashtruara më lart. Vendosja si titullar të lëndës të një pedagogu që nuk është më, u interpretua si fakt që ka lidhje me personin mësimdhënës që ka formuar

lëndën e Syllabusin përkatës. Për mendimin tonë ky justifikim nuk mund të qëndrojë, pasi personi titullar i lëndës duhet të jetë prezent e të kontrollojë zhvillimin e saj.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS)</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i studimit Masteri i Shkencave në “Arkitekturë” është program studimi i akredituar, në përputhje me Vendimin nr. 87, dt. 16.07.2010 të Këshillit të Akreditimit; me kohë të plotë dhe ka një kohëzgjatje prej pesë vitesh akademike, me 305 Kredite ECTS në total, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Sasia e krediteve të grumbulluara nga një student që ndjek programin e studimi me kohë të plotë Master i Shkencave në “Arkitekturë” është: 60 Kredite në vitin e parë, 62 Kredite në vitin e dytë, 61 ne vitin e tretë, 60 Kredite në vitin e katërt dhe 62 Kredite në vitin e pestë.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për</p>	<p>Studentët që përfundojnë programin e studimit “Master i Shkencave në Arkitekturë” në “Albanian University” kanë njohuri bashkëkohore, të aftë të punojnë në institucionet krijuese, projektuese dhe zbatuese, por edhe me njohuri të mjaftueshme për t`u adaptuar edhe si inxhinierë për bizneset në përgjithësi, pra t`i përgjigjet nevojave të tregut të punës.</p> <p>Programi i studimit “Master i Shkencave në Arkitekturë” është program i integruar i ciklit të dytë. Ky program i përgatit studentët për tregun e punës dhe u jep mundësi për vazhdimin e mëtejshëm të studimit në programe të të njëjtit lloj apo në programe të ngjashme, brenda dhe jashtë vendit, si dhe avancimin e studimeve në nivelin master Ekzekutiv apo në ciklin e tretë të studimeve (PHD).</p> <p>Përmes Diplomës që jepet në përfundim të studimeve të këtij programi, studentët përmbushin një nga kushtet (por jo te vetmin) që duhet për të ushtruar profesionin e arkitektit sipas ligjit në fuqi.</p>

pranimin në ciklin e tretë të studimeve;	
Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Organizimi dhe përmbajtja e programeve të programit “Master i Shkencave në Arkitekturë” është në përputhje me kërkesat e një programi të integruar të ciklit të dytë të studimeve.</p> <p>Vlerësimi i përgatitjes të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të pjesëmarrjes aktive, moduleve të pjesshme, dorëzimit/provimit përfundimtar, specifike për çdo lëndë të kurrikulës, duke i nxitur studentët që të jenë aktiv gjatë gjithë vitit.</p>
Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvijën disaveçare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomatat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Konceptimi dhe programimi i përmbajtjes mësimore të kurrikulës së programit të studimit Master i Shkencave në “Arkitekturë” është në kohezion me shkollat e këtij profili në Evropë,</p> <p>Cilësia e përmbajtjes së të gjithë elementeve përbërës të programit të studimit (objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në to, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve, përfshirë dhe metodatat e vlerësimit), bën që programi i studimit të jetë konkurrues në planin Kombëtar dhe studimet e kandidatëve të jenë të transferueshme.</p> <p>Kurrikulat e kursit të studimit janë ndërtuar mbi bazën e Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) në përputhje me Statutin e Universitetit dhe me Legjislacionin Shqiptar në Fuqi. Emërtimi i kursit të studimit është i njëjtë me emërtimet e sistemit universitar shqiptar, i reformuar mbi bazën e parimeve të Deklaratës së Bolonjës.</p>
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Programi e studimeve “Master i Shkencave në Arkitekturë” është hartuar në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim.</p> <p>Gjatë këtij programi studentët kryejnë praktika profesionale në studio projektimi me të cilat departamenti ka marrëdhënie bashkëpunimi. Njëkohësisht studentët e vitit të katërt dhe të pestë përfshihen në aktivitete kërkimore të ndryshme të zhvilluara nga stafi akademik apo edhe në Konferencën e Studentëve që zhvillon Albanian University.</p>

	<p>Në funksion të realizmi të programeve të studimeve, personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore, për të cilën në fund të çdo viti akademik referohet në një raport të përgatitur nga Departamenti.</p>
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Hartimi i programit të studimit është bërë duke marrë parasysh tendencat e përgjithshme të tregut të punësimit në Shqipëri, dhe synon t'u japë studentëve njohuri dhe aftësi të mjaftueshme për t'u bërë pjesë konkurruese e këtij tregu. Institucioni ka si praktikë, që para se të vendosë hapjen e një programi studimi të studiojë tregun e punës dhe të bëjë një sërë takimesh me aktorët e interesuar.</p> <p>Para hapjes së programit të studimit Masteri i Shkencave në "Arkitekturë", është hetuar tregu i punës dhe është vërejtur se në 2005 ka patur një nevojë për arkitektë në tregun shqiptar. Për t'i ardhur në ndihmë këtij sektori, janë zhvilluar dhe takime me Institucione të ndryshme shtetërore. Gjithashtu është studiuar tregu në lidhje me numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme.</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit "Masteri i Shkencave në Arkitekturë", nuk bie ndesh me vlerat kulturore kombëtare, përkundrazi ai i nxit ato nëpërmjet promovimit të elementëve estetikë e arkitektonikë. Në lëndë të veçanta të Programit trajtohet vendi që zë kulturë arkitektonike shqiptare në kulturën botërore, përshkruhet evoluimi i saj apo, dhe si ajo është influencuar nga aspektet e kulturës materiale dhe shpirtërore.</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>Pavarësisht se Standardi mbështete në ligjin 9741/2007/i ndryshuar, edhe Ligji i ri i Arsimit të lartë 80/2015 ka të njëjtat kritere.</p> <p>Programi Masteri i shkencave në "Arkitekturë" realizohet me 305 ECTS me një kohëzgjatje prej 5 vitesh akademike, me kohë të plotë. Në të përfshihen edhe kreditet e parashikuara për mbrojtjen diplomës. Institucioni deklarohe në dijeni të kushtit: të paktën 300 kredite dhe është i vetëdijshëm për 5 kredite më shumë,</p>

	shtesën e të cilave e justifikon me domosdoshmërinë për ti dhënë peshë lëndëve të projektimit në vitet e fundit.
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	Sipas Rregullores së Departamentit të Arkitekturës e dokumentacionit rezulton se në fillim të çdo semestri, studentët marrin nga pedagogu informacionin e nevojshëm mbi programin e lëndës që do të zhvillojnë. Në fillim të vitit akademik, pedagogu titullar i lëndës, dorëzon pranë Departamentit të Arkitekturës syllabuset apo programin për lëndën përkatëse. Departamenti pasi miraton programin e lëndës ia transmeton atë zyrës së kurrikulave. Syllabuset mund të konsultohen pranë Departamentit.
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	Rregullorja e programit të studimit "Master i Shkencave në Arkitekturë", Neni 30-32 (Aneksi 5), shpjegon mënyrën e hartimit të temës së diplomimit, anën procedurale të diplomimit, mënyrën e caktimit të drejtuesit shkencor të projektit, mbrojtjen e diplomës dhe përmbajtjen e komisionit të diplomimit. Programi "Master i Shkencave në Arkitekturë" përbëhet nga 305 kredite ECTS nga të cilat 30 kredite janë të parashikuara për projektin e diplomës.
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Bazuar në raportin e vlerësimit të brendshëm RVB, në dokumentacionin e sjellë pranë ASCAL si dhe në vizitën në Institucion mendojmë se:</p> <p>Institucioni ka përmbushur objektivat për të hartuar një program Master Shkencor në Arkitekturë i cili kënaq startegjinë e tij për të përgatitur studentë me një formim të gjërë profesional në fushën e Arkitekturës. Studentët që përfundojnë këtë program studimi fitojnë njohuri bashkëkohore, mund të jenë të aftë të punojnë si inxhinierë arkitektë në institucionet krijuese, projektuese dhe zbatuese. Kurrikula dhe syllabuset përgatiten nga departamenti i cili i raportin e depoziton në Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave pranë Universitetit. Kur ka ndryshime në to, ato raportohen në një raport të posaçëm e depozitohen pranë kësaj zyre.</p> <p>Ndër këto ndryshime, të evidentuara edhe më lart, duket e paarsyeshme rritja e krediteve për lëndë të karakterit formues e ulja e krediteve për lëndë të rëndësishme të formimit karakterizues për arkitektin.</p> <p>Për të përmirësuar cilësinë e formimit të studentëve e të mësimdhënies në këtë program rekomandojmë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ të rishikohet plani mësimor për të mundësuar uljen e sasisë së krediteve nga 305 në 300 	

- të ulet numri i provimeve që jepen në çdo semestër, duke parë mundësinë e bashkimit në module.
- të ulet numri i krediteve për disa lëndë të karakterit formues e inxhinierik (Matematikë 1 dhe 2, Shkencë konstruksioni 1 dhe 2, Materiale ndërtimi)
- të shihet mundësia për të vendosur në Planin Mesimor lëndë të lidhur me kërkimin shkencor apo shkrimin akademik.
- të rishikohen disa prej syllabuseve për të mundësuar eliminimin e pasaktësive apo përmirësimin e tyre në aspektet e metodologjisë së zhvillimit të orëve praktike, laboratoreve, detyrave e Projekteve të kursit, si edhe në informacionin mbi literaturën e rekomanduar.
- të vendosen kredite/ orë leksion për Lëndët Elementë Projektimi e CAAD, për të mundësuar rritjen e sasisë e cilësisë së njohurive të dhëna gjatë mësimin.
- Në përcaktimin e stafit mësimdhënës për çdo lëndë të shihet me prioritet fakti që njëri prej pedagogëve të jetë PAE (pedagog i brendshëm) me qëllim që të mundësohet kontrolli më i mirë i cilësisë në zhvillim të lëndës.
- Të përcaktohen e të ndiqen politika zhvillimi akademik si dhe të rekrutimit të stafit akademik PAE dhe PAK, me qëllim që të rritet numri i pedagogëve me tituj shkencorë e me eksperiencën e kualifikimin e duhur për të zhvilluar mësim. Mungesa e politikave të tilla mund të jetë faktor që ka çuar në rënien e vazhduar të numrit të studentëve të regjistruar në këtë program.

Nga RVB dhe vizita në Institucion, kuptohet se tashmë, në krahasim me kohën e Liçencimit, ka ndryshuar struktura që është përgjegjëse për realizimin e Programit Master në Arkitekturë. Nga Fakulteti i Arkitekturës, është reduktuar në Departament i Arkitekturës, në varësi të Fakultetit të shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë.

Mendojmë se ky dobësim struktural nuk influencon pozitivisht në ecurinë por sidomos edhe në cilësinë e Programit mësimor.

Numri i studentëve që regjistrohen e frekuentojnë këtë program ka ardhur në rënie sidomos në 3 vitet e fundit. Thënë kështu, fakulteti apo Departamenti përgjegjës duhet të mendojnë për një strategji sjelljeje dhe veprimesh që të çojnë në rikthimin e frekuentimit në këtë Program. Kjo mund të bëhet duke ndryshuar apo pasuruar pjesërisht apo tërësisht kurrikulën, që të mund të ofrohet një specializim specifik në formimin e tyre, dhe jo vetëm një formim i përgjithshëm në arkitekturë.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Proçesi i mësimdhënies përcaktohet në rregulloren e brendshme të Programit të studimit të cilës i referohemi (duke qenë se vizita në institucion u bë në periudhën kur nuk kishte filluar proçesi mësimor). Duke ju referuar neneve të kësaj rregulloreje, citojmë:

Mësimdhënia është e organizuar në leksione, seminare dhe praktika laboratorike. Stafii përdor metoda mësimore interaktive; në mënyrë që studentët të bëhen pjesë e këtij procesi.

Puna mësimore zhvillohet në bazë grupi e kursi, seminarët dhe praktikat zhvillohen në bazë grupi mësimor, duke respektuar standardet e përcaktuara në Udhëzimet e MAS-it si dhe në përputhje me mundësitë reale që disponon fakulteti në mjedise shkollore dhe në personel. Ndarja e studentëve në grupe fiksohet në regjistrat vjetorë, të cilët janë dokumente zyrtare, ku evidentohet zhvillimi i orëve të leksioneve nga pedagogë të jashtëm, të brendshëm dhe frekuentimi i tyre nga studentët. Regjistri i grupit është një dokument zyrtar, që evidenton frekuentimin e studentit, i cili i jep të drejtën të dhënies së provimit.

Gjatë studimeve përdoren Instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programit të studimit, si:

- *kontroll të vazhdueshëm ndaj studentëve gjatë të gjithë periudhës semestrale*
- *vlerësim të performancës së pedagogëve dhe të gjithë stafit pedagogjik*
- *dokumentim të detajuar të realizimit të planit mësimor për çdo lëndë dhe për çdo pedagog*
- *kontroll të vazhdueshëm ndaj cilësisë së programit dhe inovacioneve që sjellin pedagogët për çdo lëndë*

Pasi realizohen këto forma vlerësimi, departamenti bën një analizë të aktivitetit mësimdhënës e nxjerr konkluzionet të cilat mund të pasohen me ndryshime të kurrikulës, etj.

Një nga format e vlerësimit që institucioni përdor, është anketimi i vazhdueshëm i studentëve, të cilët ndër të tjera i përgjigjen edhe pyetjeve të lidhura me procesin e mësimdhënies. Rezultate e këtyre anketimeve reflektohen në tabela përmbledhëse që depozitohen në njësinë e sigurimit të cilësisë së brendshme.

Në RVB institucioni shprehet se: *Pedagogët që nuk arritën të realizojnë objektivat në vitin akademik, kanë vlerësimet e tyre që merren në konsideratë edhe në marrëdhëniet kontraktuale që kanë me institucionin.*

Në lidhje me Frekuentimin nga ana e studentëve, rregullorja shprehet:

Lëndët zhvillohen sipas orarit mësimor të shpallur, të ndërtuar mbi kritere pedagogjike me qëllim shpërndarjen e ngarkesës mësimore në mënyre të balancuar. Leksionet, seminarët dhe praktikat janë të detyrueshme për vazhdimin e studimeve në Masterin e Shkencave në "Arkitekturë". Frekuentimi i leksioneve, seminareve dhe praktikave në të paktën 75% të seancave është i detyrueshëm, për të siguruar numrin e krediteve dhe lejimin për t'u provuar në lëndën përkatëse.

Departamenti në këtë program studimi përdor edhe një praktikë tolerante në lidhje me sasinë e frekuentimit të seminareve nga studentët. Për ata që kanë 25-50% të seminareve të pa frekuentuar, futja në Provim nuk lejohet në sezonin e rregullt, por mund të bëhet në sezonin pasardhës. Gjatë kësaj periudhe studenti mund të përfitojë nga konsultime të bëra me pedagogun e lëndës.

Provimet dhe kontrollet e pjesshme janë të detyrueshme për të gjithë studentët.

Ora mësimore akademike ka një kohëzgjatje prej 60 minutash, me një ngarkesë në auditor të studentit 20-25 orë mësimore.

Në rregulloren e Programit saktësohen edhe aspekte të lidhura me provimet e vlerësimet e studentëve:

Vlerësimi i një lënde bëhet me cikle, kontrolle/provime të pjesshme dhe provim/dorëzim përfundimtar. Në detyrimet e studentit përfshihen lëndë të detyrueshme dhe lëndë fakultative me zgjedhje, në diskrecionin e studentit. Njohuritë e përfuara mund të vlerësohen me një kombinim të frekuentimit, aktivizimit të studentit përgjatë orëve të

leksioneve, provimi me shkrim/dorëzimit të projektit të kursit, detyra e kursit apo prezantime të detyrave.

Në sesionet e provimeve studenti vlerësohet në të gjitha lëndët.

Provimet vlerësohen me notë, të shprehur në të dhjeta, duke filluar nga nota minimale kaluese 5 (pesë) deri në notën maksimale 10 (dhjetë).

Në rregulloren e programit të studimit përcaktohen format e ndryshme të vlerësimit, të cilat zhvillohen sipas afateve të përcaktuara në kalendarin akademik, të bëra publike nga Departamenti i Arkitekturës dhe janë të detyrueshme si për pedagogët ashtu dhe për studentët.

Nota e studentit është e "ndërtuar"; kjo do të thotë që studentit testohet gjatë semestrit në secilën lëndë përveç provimit në sezon. Shumatorja e pikëve të mbledhura përbën vlerësimin e tij përfundimtar.

Forma e vlerësimit realizohet në përputhje me vendimet e Senatit të Albanian University. Formula e vlerësimit të studentëve për çdo lëndë është e prezantuar në syllabuse-t e lëndëve.

Në fillim të çdo semestri pedagogët iu bëjnë të ditur studentëve modelin dhe formulën e kontrollit të njohurive të tyre përgjatë semestrit dhe në fund të tij. Vlerësimi i studentëve bëhet me pikë dhe germë, siç paraqitet në Tabelën 11 ne aneks:

Kontrollet/provimet e pjesshme dhe dorëzimet apo provimet përfundimtare zhvillohen brenda afatit të caktuar në strukturën e vitit akademik. Datat e orareve të provimeve apo dorëzimeve shpallen jo më vonë se dy javë përpara fillimit të sesionit.

Sezoni i provimeve zgjat 2-3 javë, periudhë kjo shumë e shkurtër për të favorizuar përgatitjen e mirë në numrin e shumtë të provimeve që jepen.

Për procedurën e Provimeve në rregulloren e brendëshme të Programit përcaktohet:

Provimet dhe dorëzimet përfundimtare janë forma kryesore e vlerësimit të njohurive. Studentët merren në provim/dorëzim nga titullari i lëndës dhe asistenti i tij. Në lëndët të cilat kanë provim teorik, tezat e provimit formulohen nga titullari i lëndës dhe miratohen nga Shefi i Departamentit, e më pas vlerësimi me notë i studentit shënohet në fletën e provimit dhe në procesverbalin e provimit.

Vlerësimi i përgatitjes së studentit për lëndët vjetore mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementeve të mëposhtëm:

- Pjesëmarrja aktive në orët e mësimi: 10 % (10 pikë)
- Provimi / Kontrolli i pjesshëm: 20 % (20 pikë)
- Plotësimi i detyrimeve (detyrave të kursit): 10-20 % (14 pikë)
- Provimi / Dorëzimi Përfundimtar: 50-60 % (56 pikë)

Në lidhje me procedurën dhe temën e Diplomës i referohemi rregullores së brendshme dhe RVB-së, citojme se:

Në përfundim të kursit të plotë të studimeve, pra me shlyerjen e plotë të detyrimeve, studenti i sistemit pesëvjeçar, fiton diplomë në Programin e Studimit Master i Shkencave në "Arkitekturë".

Proçesi i diplomimit realizohet me anë të mbrojtjes së diplomës me një projekt/studim, tema e së cilës miratohet nga Departamenti javën e parë të semestrit të dytë. Si udhëheqës të diplomës, përparësinë e kanë anëtarët e stafit të Departamentit të

Arkitekturës si dhe arkitektë dhe specialistë efektivë ose jo, që Departamenti ka aktivizuar ose jo në procesin mësimor.

Projekti i Diplomës mund të udhëhiqet nga një ose dy udhëheqës. Një nga udhëheqësit ka të paktën gradën shkencore "Doktor".

Nga vizita në Institucion, në takimin me Përgjegjësën e Departamentit rezultoi se studentët mund të marrin temën e Diplomës pa një kusht paraprak të krediteve të fituara apo provimeve të marra, mjafton që të jenë të regjistruar në vitin të pestë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (Tabela 12, në Aneks):

Mësimdhënia në këtë program studimi organizohet në bazë të proceseve didaktike të organizuara në:

- Leksione
- Seminare
- Laboratore
- Praktikë lëndore
- Praktikë profesionale
- Detyra Kursi
- Projekte Kursi

Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies (Tabela 13 në Aneks)

Ngarkesa totale në auditor, përgjatë të 5 viteve të studimit, llogaritet gjithsej 3045 orë, ndër të cilat 1140 leksione, 510 seminare e 1395 praktikë/laborator. Mesatarisht për çdo vit mësimor llogariten 609 orë në auditor.

Nga Plani mësimor rezulton se orët në auditor janë sipas viteve:

- Viti I 615 orë në auditor
- Viti II 720 orë në auditor
- Viti III 720 orë në auditor
- Viti IV 705 orë në auditor
- Viti V 285 orë në auditor (ku futet edhe diploma)

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj (Tabela 14 në Aneks)

Në Tabelën 14 jepen të dhëna për aktivitete shkencore dhe përfshirjen e studentëve në to

Kjo tabelë është deklaruar në RVB dhe duhet parë me rezervë, duke ditur se Departamenti nuk ka projekte shkencore të deklaruara.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Në programin e studimit Master i Shkencave në “Arkitekturë” kualifikohen ata kandidatë që kanë përfunduar me sukses maturën shtetërore ose zotërojnë një diplomë ekuivalente studimi të fituar në vende të tjera të njohura nga autoritetet zyrtare dhe ligjet në fuqi.

Procedurat e pranimit të studentëve

Regjistrimi dhe transferimi të studentëve i IAL i referohet Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit për hapjen e regjistrimeve e për fillim të vitit të ri akademik.

Dokumen tet që duhen të paraqesin studentët janë:

1. Diplomë e maturës shtetërore së bashku me certifikatën e notave. Dëftesën e shkollës së mesme të fituar jashtë vendit ekuivalentuar pranë Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës.
2. Dëftesë pjekurie të shkollës së mesme (kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2011).
3. Fotokopje e kartës se identitetit, letër njoftimit ose pasaportës.
4. 4 fotografi
5. Formulari i aplikimit

Cilësia në hyrje e studentëve

Nota mesatare në hyrje që në vitin 2010-2015 është 7.38. Per vitet e tjera nuk mund të shkruhet pasi se nuk ka pasur regjistrime

Numri i studentëve për herë të parë në vit të parë në hyrje dhe në dalje në vite

Gjatë vizitës në institucion dhe në sekretarinë mësimore, morëm të dhënat të evidentuara në tabelën e mëposhtme (Tabela 15) dhe Tabela 16, në Aneks), ku reflektohet numri i studenteve të rregjistruar për çdo brez studimi, numri i të transferuarve, numri i atyre që kalojnë në stazh në brezat përkatës, numri i të diplomuarve, numri i të çregjistruarve.

Tabela 15

Sipas Viteve	Te regjistruar per here te pare ne vitin e pare (a)	Studentete transferuar sipas viteve(B)					Studente te transferuar per Brezat (b)	Totali: (a)+(b)
		Viti I	Viti II	Viti III	Viti IV	Viti V		
2005-2006	37						0	37
2006-2007	141		1				1	142
2007-2008	85		2				2	87
2008-2009	93		4				4	97
2009-2010	66		5	2	1	2	10	76
2010-2011	54		6	2			8	62
2011-2012	60		5	3		1	9	69
2012-2013	18		3	3	7		13	31
2013-2014	19		2	5	4	2	13	32
2014-2015	20		3	14	3	1	21	41
2015-2016	0		1	0	4	2	7	7

2016-2017	8	1		2	1		4	12
2017-2018	0		3	3	1	5	12	12
	601						104	705

Studentë të diplomuar që nga brezi 2010-2015 deri në tetor 2017 e tani, është 54.

Ndërkohë pritet të diplomohen studentë e brezit 2013-2018 e në vazhdim, të cilët deri më tani janë 41 vetë. Këtij numri do t'i shtohen edhe studentë të brezave të mëparshëm, ata të cilët nuk kanë arritur të kryejnë në kohë përfundimin e studimeve.

Nga studimi i shifrave në tabelë kuptojmë se numri i studentëve që regjistrohen në këtë program studimi ka qenë vazhdimisht në rënie që prej vitit 2011, konkretisht me një përgjysmim në vitin 2012, me një stabilizim në të njëjtën shifër për tre vjetët në vazhdim, e me një zvogëlim drastik në 2015 dhe në mungesë studentësh në vitin 2017.

Nga tabela vihet re gjithashtu, se është i konsiderueshëm edhe numri i të çregjistruarve apo të larguarve, i cili që prej hapjes së programit në 2005, është 103 , gati 15% i numrit të të rregjistruarve për herë të parë.

Përsa i takon numrit të të diplomuarve, sipas llogaritjeve rezulton se deri më tani janë diplomuar 311 studentë dhe duke llogaritur edhe të ç'regjistruarit, nga ata që frekuentojnë këtë program studimi, mbeten akoma pa u diplomuar në total 279 vetë.

Koha mesatare e zgjatjes së studimeve

Programi i studimeve Master i Shkencave në "Arkitekturë" zgjat si rregull, 10 semestra ose 5 vite akademike. Brenda këtyre semestrave përfshihen si forma mësimore: leksionet, seminarët, laboratorët, projektet, detyrat e kursit, dhe angazhime të tjera akademike.

Duhet theksuar se kjo kohëzgjatje është për studentët që arrijnë të mbyllin ciklin në kohë të rregullt akademike, ndërkohë që nga tabela vëmë re se këta studentë përbejnë një përqindje të vogël. Një pjesë e mirë e studentëve, të aktivizuar në punë apo të mbetur në Stazh, nuk kanë arritur të diplomohen, duke zgjatur kështu kohët e studimit e të diplomimit.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Regjistrimi dhe transferimi të studentëve i IAL i referohet Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit për hapjen e regjistrimeve e për fillim të vitit të ri akademik.

Dokumentet që duhen të paraqesin studentët janë:

- Diplomë e maturës shtetërore së bashku me certifikatën e notave. Dëftesën e shkollës së mesme të fituar jashtë vendit ekuivalentuar pranë Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës.
- Dëftesë pjekurie të shkollës së mesme (kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2011).
- Fotokopje e kartës së identitetit, letër njoftimit ose pasaportës.
- fotografi
- Formulari i aplikimit

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve. Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Të dhënat për parametrat e mësipërm reflektohen në Tabelën 17 (në Aneks).

Nga tabela del se për rregjistrime të viteve 2010, 2011, 2012, nga numri total i te regjistruarve për herë të parë 132 studentë, vetëm 22 janë diplomuar në kohë të rregullt, duke përbërë kështu vetëm 16% të të regjistruarve.

- Mobiliteti (transferimi i studimeve) i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend (shih Tabelën 18).

Në programin master shkencor arkitekturë, pranohen edhe studentë nga institucione analoge të arsimit të lartë, të cilët transferohen nga programe ekuivalente dhe kalojnë procedurëat e transferimit kriterive rekomanduara nga ligji në fuqi.

- Të dhëna për punësimin e studentëve. Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën). Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Të dhënat jepen në Tabelën 19. Sipas deklaratimit nga institucioni, ne RVB rezulton se nga 311 te diplomuarit që prej hapjes së programit në 2005, 299 janë të punësuar, ndërkohë që prej tyre, 101 janë të punësuar në përputhje me diplomën.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Pranimi në programin e studimit të integruar është bërë në përputhje dhe në zbatim të Ligjit 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi. Në program pranohen studentë që kanë mbaruar shkollën e mesme dhe kane dhënë provimet e maturës shtetërore. Studentët e regjistruar plotësojnë kriteret e përcaktuara nga AU për regjistrimin e tyre si dhe paraqesin dokumentacionin e kërkuar për regjistrim.</p> <p>Të gjithë studentët e programit të studimit të integruar në Arkitekturë të cilët janë regjistruar për herë të parë në vitin akademik 2010-2011 e në vitet akademike në vijim, kanë si detyrim ligjor mbrojtjen e gjuhës angleze para diplomimit sipas nivelit të përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.</p> <p>Institucioni deklaron se vlerëson herë pas here kriteret e pranimit në bazë të vështirësisë ose jo në plotësimin e kërkesave, dhe ku është e mundur dhe e lejuar nga legjislacioni në fuqi si dhe nga universitetet partnere, bën modifikimet që shikon të arsyeshme.</p>
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.	

<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit, në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Gjithashtu atyre u jepet informacion mbi akreditimin ose jo të programit ku aplikojnë dhe mbi vlefshmërinë e diplomës që marrin brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Në institucion funksionon Zyra e Karrierës, Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve e cila i ofron studentëve informacionin e nevojshëm për të përzgjedhur karrierën e tyre duke i ndihmuar të azhurnohen mbi kërkesat e tregut të punës në fushat përkatëse. Vetë institucioni ka punësuar rregullisht studentët më të mirë, në varësi dhe të mundësive të krijuara për punësim. Nga biseda me përgjegjësen e kësaj zyre u kuptua angazhimi i anëtarëve të saj në këtë drejtim.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Ky informacion disponohet si në format elektronik ashtu dhe në hard copy pranë zyrave të sekretarisë, por nuk ka akoma nje sekretari elektronike te konsultueshme on-line nga studentet dhe pedagoget.</p> <p>Institucioni disponon pranë zyrave të sipërpërmendura, të dhëna të sakta për të gjithë studentët e regjistruar në të gjitha ciklet e studimit, tërheqjet nga programi, largimet si dhe mbi ecurinë akademike të tyre deri ditën e diplomimit, si në format elektronik ashtu dhe në hard-copy, të gjitha të dhënat e studentëve, modulet dhe provimet që marrin përfshirë dhe notën përfundimtare të diplomimit. Këto të dhëna u verifikuan në sekretarinë mësimore.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në</p>	<p>Institucioni disponon, mban dhe përditëson përmes ZKS bazë të dhënash të punësimit të studentëve që janë të interesuar të kenë kontakte me Albanian University. Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e</p>

ciklet e tjera të studimeve etj.	tjera të studimeve. Nga vizita në institucion dhe biseda me drejtuesen e ZKS, u certifikua angazhimi i institucionit në këtë drejtim.
Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	Nga RVB dhe vizita në institucion mësohet se Departamenti i Arkitekturës mban kontakt të drejtpërdrejtë me studentët, duke i informuar ata për ecurinë e çdo kursi studimi, hapjen e kurseve të reja, akreditimin e tyre, pikat e dobëta dhe të forta të procesit, etj. Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit, gjatë dhe në përfundim të procesit të vlerësimit
Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Institucioni u ofron këshillim të vazhdueshëm studentëve, lidhur me problematikat e ndryshme që dalin gjatë gjithë procesit mësimor. Departamenti i Arkitekturës bëhet zëdhënës ndërmjet studentëve dhe Rektoratit për zgjidhjen e problemeve të ndryshme. Zyra e Karrierës, Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve, informon studentët mbi kurrikulat përkatëse, si dhe orientimin e tyre drejt programeve të tjera të studimeve ku ata kanë të drejtë të aplikojnë, si dhe i orienton në tregun e punës, me anë të informimit të vendeve të lira si dhe ndihmesës në aplikimin për punësim, duke ndërmjetësuar procesin mes punëdhënësve potencialë dhe studentëve.</p> <p>Në departamentin e Arkitekturës është organizuar edhe Klubi i Studentëve të Artit e Dizajnit, anëtarët e të cilit janë të zgjedhur nga çdo grup mësimor e shërbejnë si ndërmjetës ndërmjet Departamentit, Zyrës së sigurimit të cilësisë së brendshme apo edhe Zyrës së Karrierës, Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve. Nëpërmjet tij studentët informohen për aktivitetet që organizohen e ku ata mund të marrin pjesë, si konkurse, ekspozita, leksione të hapura apo edhe konferenca. Vetë Departamenti i Arkitekturës çdo vit nënshkruan kontrata bashkëpunimi me zyra projektimi dhe institucione shtetërore në të cilat studentët mund të zhvillojnë praktikën.</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

Numri i studentëve që frekuentojnë këtë program studimi ka qenë në rënie prej vitit 2012 e në vazhdim, deri në mosregjistrime në vitin 2015-2016 si dhe në 2017-2018. Nga studentët që janë pjesë e këtij programi që prej fillimeve të hapjes së tij llogariten rreth 279 studentë që presin të diplomohen. Duke patur parasysh numrin e shumtë të studentëve që akoma nuk kanë mbyllur ciklin e studimit me diplomim, do të ishte e mirë që Departamenti të gjente një mënyrë komunikimi me to, me qëllim për ti këshilluar, nxitur e pse jo edhe asistuar me ndihmë didaktike, që të bënte të mundur finalizimin e studimeve të tyre.

Ndërkohë studentët informohen në mënyrë periodike edhe për gjendjen e frekuentimit në secilën lëndë si dhe për rezultatet e vlerësimit në module dhe atij në provime. Këto informacione ju komunikohen atyre gojarisht nga stafi akademik ose nga Sekretaria Mesimore. Për të ndihmuar në informimin e tyre në kohë do të ishte e këshillueshme të përfundojë sa më parë sistemi i sekretarisë elektronike, i cili do të ishte i arritshëm on-line.

Studentët (favorizuar nga numri i pakët) kanë mardhënie të mira komunikative e didaktike me anëtarët e departamentit të Arkitekturës dhe ndjehen të përfshirë në aktivitetet që organizohen në Departament, Fakultet e Universitet.

Studentët kanë akses të vazhdueshëm në laboratorin CAAD dhe në sallën e kompjuterave në bibliotekë, në të cilat janë instaluar programet për vizatim me kompjuter, por që mund të pasurohen edhe me programe të tjera grafike, që të mund ti shërbejnë më mirë për përgatitjen e projekteve.

E rekomandueshme do të ishte që të krijohej edhe një pikë printimi për projektet e tyre, e cila e organizuar pranë departamentit të mund të ofronte asistencë gjatë procesit e pse jo edhe çmime më të ulëta.

Lidhur me sa më lart rekomandojmë:

- Të krijohet sa më parë Sekretaria Mësimore Elektronike, e konsultueshme on-line
- Të shihet mundësia për të shtuar programe grafike në kompiuterat e laboratorit CAAD si dhe në ato të Sallës së studimit pranë Bibliotekës.
- Të organizohet një qendër printimi brenda ose pranë godinës ku zhvillohet ky program mësimor, që të mundësojë asistencë teknike e çmime të lehtësurara për studentët.
- Të krijohen strategji sjelljeje e mënyra komunikimi me studentët e pa diplomuar akoma, me qëllim për ti këshilluar, nxitur e pse jo edhe asistuar me ndihmë didaktike, me qëllim që të bëhet e mundur finalizimi i studimeve të tyre.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Për realizimin e programit Master Shkencor në arkitekturë janë angazhuar Profesorë, Profesorë të Asociuar, Doktorë të diplomuar dhe Pedagogë me gradën Msc, pjesërisht si PAE, e pjesërisht si PAK.

Sipas RVB institucioni deklaron: *Veprimtaria kërkimore-shkencore e Albanian University përqendrohet, kryesisht:*

- në realizimin e kërkimit shkencor e të aplikuar;
- në mbështetjen e veprimtarisë së stafit akademik, aftësimin dhe kualifikimin e tij;
- në integrimin e kërkimit shkencor në mësim;
- në krijimin e një raporti të drejtpeshuar dhe efektiv ndërmjet mësimdhënies e kërkimit shkencor;
- në krijimin e shprehive dhe të metodave kërkimore shkencore në studentët, duke i aktivizuar ata me detyra, konkurse, tema diplomash apo edhe në përfshirjen e tyre në grupet studimore projekte që ka departamenti me institucione shtetërore apo dhe private.

Duke diskutuar mbi këto prioritete, kuptojmë se në institucion bëhet kërkim shkencor (konferenca e botime) por mbetet të vlerësohet sasia dhe intensiteti i tyre në funksion të mësimdhënies.

Istuticioni zhvillon edhe trajnim të stafit akademik, por vetëm në kuadër të leksioneve teorike mbi mësimdhënien në aspekt pedagogjik, ndërkohë që do të duhet të intensifikojë trajnimet apo specializimet profesionale të tyre, duke investuar financiarisht në mobilitete të anëtarëve të stafit PAE.

Përsa i përket mbështetjes së stafit akademik në veprimtarinë e tij për kualifikim, institucioni mjaftohet me mbështetje të pjesshme të dy studentëve të shkollës së Doktoraturës, duke mundësuar largimin e tyre nga puna dhe regjistrimin në universitetin e huaj në bazë të marrveshjeve të bashkëpunimit ndëruniversitar.

Gjatë vizitës në institucion u deklarua se Institucioni organizon:

- ekspozita të punimeve të studentëve;
- guidave mësimore në qytete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit;
- leksione të hapura shkencore me pedagogë dhe personalitete të njohur vendas dhe të huaj mbi tema të ndryshme .
- Konferenca Shkencore dhe studentore;
- Botimi i Revistës Shkencore Optime, revistë e AU e krijuar që në 2010 e hapur edhe për publikimin e punimeve të pedagogëve dhe studiuesve të rinj.

Një analizë për këtë aktivitet shkencor bëhet në konkluzionet e vlerësimit në fund të kësaj pike.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor (shih Tabelën 20)

Kërkimi shkencor është një element përbërës dhe kontraktual i ngarkesës së pedagogëve në "Albanian University". Për të bëhet, në përfundim të çdo viti Akademik, një raport i punës shkencore në të cilin pasqyrohen aktiviteti i secilit pedagog të stafit akademik, efektiv apo me kontratë.

Treguesit e veprimtarisë kërkimore të tyre maten me pjesëmarrje në referime në konferenca shkencore, me botime të artikujve në revista shkencore ose me botime të ciklit të leksioneve të shkruara, të librave mësimorë apo të monografive.

Në Tabelën 20 evidentohen 31 botime nga stafi akademik efektiv, mesatarisht 4 të tilla për çdo vit akademik, dhe 0 projekte kërkimore të fituara.

Sipas parametrave kontraktuale të vendosur nga ky IAL, pedagogët duhet të marrin pjesë në minimumi 2 konferenca në vit, si dhe të botojnë minimumi 2 artikuj në revista shkencore.

Me sa duket ky numër nuk është respektuar duke çuar automatikisht në numrin e ulët të punëve shkencore, i cili evidentohet në tabelën 20.

Departamenti ka gjithashtu një bazë të dhënash ku reflekton punimet nga viti 2010 deri më tani.

AU publikon revistën periodike "OPTIME" e cila përmban shkrime shkencore të pedagogëve të institucionit, por edhe shkrime të studiuesve jashtë AU.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disipinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>AU organizon Konferencën e tij shkencore dhe publikon revistën shkencore "Optime". Personeli akademik publikon artikuj e materiale shkencore në disipinat përkatëse. Duhet theksuar se edhe pse të paktë në numër (31 për periudhën 2010-2017) si çdo kërkim apo studim, ato influencojnë në zhvillim, pavarësisht se arkitektura nuk është një shkencë e mirëfilltë.</p> <p>Ndërkohë Institucioni duhet te angazhohet për të rritur numrin e këtyre punimeve shkencore duke u vendosur jo në pozita pritëse apo pasive, por duke shtuar buxhetin për kërkim shkencor, si dhe punën për të fituar projekte të përbashkëta shkencore.</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Albanian University ka marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Pizës dhe Padovës. Pedagogë nga këto institucione zhvillojnë mësim në disa prej lëndëve të projektimit, si studio arkitekture e projektim ambiental. Nga vizita në departament mësuam se këta pedagogë kanë eksperimente disavjeçare në Fakultetet prej nga vijnë, zhvillojnë mësim në gjuhën italiane, dhe përkthehen nga pedagogët asistentë të lëndës.</p>
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të	

mëtejshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Institucioni ofron ndihmesën e tij në kualifikim profesional të stafit të tij, me anë të organizimit të leksioneve të hapura apo seminareve me pjesëmarrjen të profesionistëve të fushës kombëtare dhe ndërkombëtare. Por duke u nisur nga numri i paktë i këtyre aktiviteteve, si dhe nga karakteri sporadik i tyre, gjykojmë se institucioni duhet të shtojë punën në drejtim të organizimit jo vetëm të këtyre leksioneve e seminareve por edhe të investojë në kualifikimin profesional të stafit, i cili, i ndikuar direkt nga buxheti i institucionit, duhet të rrisë kualifikimin e tij dhe të influencojë më pas, drejtpërdrejt në rritjen e aktiviteteve studimore e shkencore të Departamentit. Duke qenë se ka një lidhje të drejtpërdrejtë mes cilësisë së stafit, kërkimit shkencor e buxhetit për të, mendojmë se institucioni duhet të ketë mirë parasysh përmirësimin në të tre këto drejtime.</p> <p>Bashkëpunimi me Universitetin e Pizës dhe Padovës ka mundësuar 2 prej pedagogëve të brendshëm në ndjekjen e ciklit të tretë të studimit (PHD) në këto Universitete.</p>

Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore apo të botimeve (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi. Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>
---	--

Konkluzionet e vlerësimit:

Bazuar në raportin e vlerësimit të brendshëm, dokumentët e sjellë dha nga vizita në institucion mendojmë:

Kërkimi shkencor në funksion të këtij programi studimi organizohet në bazë departamenti, universiteti por edhe në bazë të inisiativës vetjake të stafit pedagogjik, i cili ka interesat profesionale të lidhura me fushën e arkitekturës. Universiteti organizon konferencë ndërkombëtare dhe konferencë studentësh, duke influencuar në krijimin e kushteve për të propaganduar rezultatet e kërkimit shkencor.

Departamenti i Arkitekturës, i cili është përgjegjës për këtë program studimi, monitoron punën kërkimore shkencore të Personelit akademik efektiv dhe atë me kontratë te

angazhuar në këtë program studimi, duke hartuar në fund të çdo viti akademik një raport të dhënash për këto aktivitete. Mendojmë se ky qëndrim thuhet pasiv ndaj kërkimit shkencor (duke pritur vetëm që pedagogët të bëjnë punë individuale kërkimore), duhet të transformohet në një qëndrim aktiv.

Departamenti duhet të krijojë projekte kërkimore e të aplikojë në mënyrë fituese sëbashku me partnerë të tjerë, për të zhvilluar një bërthamë të kërkimit shkencor në të cilën të përfshihen pedagogë e studentë. Departamenti në bazë të pasqyrave financiare, reflekton mundësinë edhe për të financuar këto projekte. Nënvizojmë si fakt negativ, që në vitin e fundit, vetëm 567.000 lekë janë destinuar për kërkim shkencor (67.000-kerkim shkencor, 500.000 –fond ekselence), ndërkohë që zëri për projekte ishte 0.

Departamenti ka marreveshje bashkëpunimi me universitetin e Pizës, Palermos, Padoves, në sajë të së cilës, aktualisht një prej pedagogëve të tij, po zhvillon studimet e ciklit të tretë PhD në Universitetin e Padovës. Ndihmesa e Departamentit për këtë student nuk është financiare, por kufizohet vetëm në favorizim të largimit të tij të përkohshëm për periudha të shkurtra (me anë të lejes institucionale të dhënë prej tij). Mendojmë se në kushtet e këtij institucioni do të ishin të gjitha mundësitë të kontribojë edhe me bursë financimi jo vetëm për këtë student por edhe për anëtarë të tjerë të stafit, me qëllim rritjen e kualifikimit profesional të tyre.

Ajo që vihet re në stafin akademik është numri tepër i vogël i pedagogëve me titull (i cili për më tepër është në ulje nga viti në vit). Justifikimi institucional se arkitektët me titull nuk preferojnë të merren me mësimdhënie, apo se nuk ka arkitektë me tituj pasi ka qenë e pahapur shkolla e Doktoraturës në Arkitekturë, duhet zëvendësuar nga një strategji e zhvillimi akademik e cila të çojë në rritje të kualifikimit të stafit efektiv të vetë Departamentit të Arkitekturës.

Thënë kështu rekomandojmë:

- Të intensifikohet puna në drejtim të përgatitjes e fitimit të Projekteve kërkimore shkencore duke forcuar institucionalisht zyrën e projekteve .
- Të stimulohet financiarisht puna kërkimore shkencore e pedagogëve e cila edhe pse për tema profesionalisht personale, mund të sjellë kualifikim akademik të tyre..
- Të propozohen çdo vit nga vetë departamenti, tema studimore shkencore për të cilat të krijohen grupe të vogla pune me pedagogë e studentë, e në bazë të rezultateve të arritur të shpërblehen financiarisht në mënyrë të diferencuar, për të bërë të mundur rritjen konkurrenciale të cilësisë, rritjen numrit të pedagogëve me titull e për pasojë edhe të cilësisë në mësimdhënie.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Duke ju referuar RVB dhe bisedës gjatë vizitës në institucion Departamenti i Arkitekturës shprehet për (citojmë):

rëndësinë e bashkëpunimit me partnerë të ndryshëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë, si një mjet i domosdoshëm për njohjen e ndërsjellë të kulturave, për zhvillimin kulturor, shkencor të njohurive dhe shpërndarjen e tyre, për të nxitur zhvillimin e projekteve të

përbashkëta me interes të ndërsjellë në fushën e projektimit. Që prej hapjes së Programit, në kuadër të Fakultetit të Arkitekturës ai ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me Universitete të huaja me qëllim për të organizuar aktivitete të përbashkëta kërkimore shkencore si edhe shkëmbime të stafit akademik. Departamenti ka gjithashtu edhe marrëdhënie me partnerë të ndryshëm vendas si institucione shtetërore apo private të sektorit të arsimit dhe ndërtimit, ndër të cilët me universitetin Politeknik të Tiranës, si edhe me studio projektimi apo ndërmarrje private që ushtrojnë aktivitet në fushën e arkitekturës e ndërtimit.

Këto marrëdhënie bashkëpunimi vërtetohen nga dokumentacioni që institucioni disponon si marrëveshje dypalëshe mes universiteteve apo institucioneve në fushat akademike apo praktike, por mendojmë se këto marrëveshje duhen të bëhen me të frytshme e duhen shfrytëzuar më mirë sidomos në aspektin e kërkimit shkencor, duke ngritur projekte të përbashkët studimorë apo shkencorë që të kenë efekte të drejtpërdrejta në procesin mësimdhënës apo në kualifikimin profesional të stafit akademik efektiv.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Të dhënat për bashkëpunimin Kombëtar dhe ndërkombëtar jepen nga RVB në Tabelën 21 dhe 22

Departamenti i Arkitekturës, i cili është përgjegjës për programin “Master shkencor në arkitekturë” ka marrëveshje bashkëpunimi me Universitete analoge në Itali, Francë e Budapest. Këto janë marrëveshje të nënshkruara që prej fillimit të hapjes së këtij Programi, kanë patur për qëllim bashkëpunim akademik në fushën përkatëse. Në sajë të tyre janë mundësuar studime PhD pranë universiteteve në Itali (2 pedagogë), Leksione të hapura të mbajtura nga arkitektë të Huaj (5 Leksione), pjesëmarrje në trajnime jashtë vendit (25 vetë) si dhe shkëmbim i stafit akademik apo dhe i studentëve (14 studentë).

Marrëveshje bashkëpunimi ky Departament ka nënshkruar edhe me institucione të vendit, si Ministria e zhvillimit Urban e Turizmit, Arkivi qendror Teknik i Ndërtimit, IMK, Arkiva Shtetit Shqiptar dhe Bashkia e Koplikut.

Ndërkohë, me objekt zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve, janë vendosur marrëveshje bashkëpunimi me Studio profesionale Private dhe me Ente privatë që zhvillojnë aktivitet në fushën e arkitekturës.

Këto institucione mbajnë kontakte me Zyrën e Karrierës, Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve, duke i ofruar informacione mbi tregun e punës e nevojave të tij për arkitektë të diplomuar, për të mundësuar kështu punësimin e tyre.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira</p>	<p>Departamenti i Arkitekturës ka marrëdhënie dhe marrëveshje institucionale me institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, publike apo private. Këto bashkëpunime bëjnë të mundur edhe shkëmbimin e stafeve akademike, personelit kërkues shkencor (në këtë rast të studentëve për PhD) dhe studentëve të programit, duke ndikuar pozitivisht në përftimin e njohurive profesionale. Institucioni ka dhe marrëdhënie</p>

<p>profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>bashkëpunimi me sektorin e biznesit në mënyrë që të lehtësojë praktikatat profesionale te studentëve si dhe integrimin e tyre në tregun e punës.</p>
<p>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Departamenti nxit bashkëpunimin ndërmjet anëtarëve të personelit brenda institucionit, me qëllim që nëpërmjet shkëmbimit të informacionit e ndërveprimit personal të mundësojë mirëfunksionimin dhe mbikëqyrjen e programit. Nga ana tjetër ky Departament organizon ndarjen e detyrave mes anëtarëve të personelit, shpërndan përgjegjësitë respektive dhe analizon punën e tyre, duke garantuar marrëdhënie të mira bashkëpunimi mes anëtarëve të stafit akademik.</p>
<p>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti i Arkitekturës ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit si dhe me aktorë të biznesit vendas, me qëllim realizimin e objektivave të programeve të studimeve. Aktualisht një pedagog i huaj zhvillon mësim në këtë program.</p> <p>Departamenti ka marrëdhënie edhe me struktura private, studio projektimi, ndërtimi dhe arredimi, me qëllim kryerjen e praktikës profesionale të studentëve. Si hallkë ndërmjetëse midis Studiove të projektimit apo bizneseve të fushës së Arkitekturës, shërben Zyra e Karrierës, Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve e cila ka një bazë të dhënash me CV dhe kontakte të studentëve të diplomuar.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Departamenti i Arkitekturës ka marrëdhënie dhe marrëveshje institucionale me institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, publike ose private. Këto bashkëpunime bëjnë të mundur shkëmbimin e stafeve akademike, dhe disa herë edhe të studentëve; duke ndikuar kështu pozitivisht në përftimin e njohurive profesionale me eksperiencën më të mirë kombëtare dhe ndërkombëtare nga ana e studentit.</p> <p>Departamenti duhet të shfrytëzojë më mirë këto marrëveshje bashkëpunimi me qëllim që në kuadër të tyre të ngrihen projekte të përbashkëta e me financim të përbashkët, të cilat të mundësojnë një zhvillim të Kurrikulave por sidomos të mundësojnë mobilitete të stafit akademik pranë Fakulteteve në Itali, me qëllim kualifikimin e tyre në aspektin profesional e të mësimdhënies.</p> <p>Ky Departament bashkëpunon me sektorin e biznesit në mënyrë që të mundësojë praktikatat studimore e profesionale gjatë viteve të studimit, si dhe integrimin e studentëve në tregun e punës pas diplomimit të tyre. Si hallkë ndërmjetëse midis Studiove të projektimit apo</p>	

bizneseve të fushës së Arkitekturës, shërben Zyra e Karrierës, Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve që ka një bazë të dhënash me CV dhe kontakte të studentëve të diplomuar.

Thënë më sipër, që të përmirësohen efektet nga bashkëpunimi me Universitetet Ndërkombëtare, rekomandojmë:

- Të rriten përpjekjet për të krijuar projekte të përbashkëta e me financim të përbashkët, të cilat të mundësojnë një zhvillim të Kurrikulave por sidomos të mundësojnë mobilitete të stafit akademik pranë Fakulteteve analoge.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- a) Rektorati i universitetit të marrë masa për të hartuar plane konkrete veprimi sidomos në nivelet e realizimit të kërkimit shkencor, të cilat duhet të jenë të matshme, të monitorueshme dhe objekt i analizave të vazhdueshme;
- b) Të krijohet mundësia për kualifikimin e personelit të ri akademik si dhe të krijohen mekanizma të qarta dhe transparentë për mbështetjen dhe financimin e aktiviteteve shkencore, në të gjitha njësitë;
- c) Të pasurohen më tej laboratorët e materialeve të ndërtimit;
- d) Të pasurohet biblioteka me literaturë edhe periodikë në fushën e arkitekturës;
- e) Të shtohen ambientet (përveç 3 ekzistuesve) që pedagogët e brendshëm të punojnë;
- f) Të shtohen përpjekjet dhe vëmëndja për informatizimin e sistemit të të dhënave pranë zyrës së burimeve njerëzore për të lehtësuar në procedurë dhe në kohë marrjen e informacionit, përditësimin e tyre dhe më pas përpunimin;
- g) Në riorganizimin e kurrikulës që Departamenti po realizon për të aplikuar në vitin akademik 2010 - 2011 të kihet parasysh ulja e numrit të provimeve nga 45 në 35 sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. 15 të datës 04.04.2008, ulja e ngarkesës mësimore për studentët sidomos për vitin e 3-të, si dhe përcaktimin e krediteve për praktikën mësimore që në kurrikulën ekzistuese është shpërndarë në javën e 15 të secilit semestër;
- h) Për zhvillimin e kërkimit shkencor do të ishte hapja e këtij të fundit dhe për publikun, në mënyrë që kërkimi shkencor, aq më tepër në një fushë kaq të aplikuar sa arkitektura dhe urbanistika, të ishte më i prekshëm duke angazhuar edhe specialistë që janë jashtë institucionit për të realizuar kërkim shkencor të aplikuar.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) *"Rektorati i universitetit të marrë masa për të hartuar plane konkrete veprimi sidomos në nivelet e realizimit të kërkimit shkencor, të cilat duhet të jenë të matshme, të monitorueshme dhe objekt i analizave të vazhdueshme"* **është plotësuar pjesërisht.**
 - Është bërë një punë e mirë në drejtim të organizimit të konferencave shkencore në rang Fakulteti, përfshirë këtu edhe dy konferenca për studentët me ambicjen për të patur cikël zhvillimi të përvitshëm;
 - Është krijuar "Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë", e cila merret edhe me monitorimin e dhe analizën e kërkimit shkencor, por ajo duhet të jetë më aktive. Nga raportet vjetore mbi kërkimin shkencor dhe ecurinë e mesimdhënies, kjo njësi duhet të bëjë analiza të thelluara dhe të rezultojë në kërkesa specifike për financim të kualifikimit profesional të stafit efektiv, duke ja drejtuar këto kërkesa instancave drejtuese të AU.
 - Pjesëmarrja në konferenca e botime shkencore (min. 2/vit) është vendosur si një kusht kontraktual në pajtimin e stafit efektiv apo dhe atij me kontratë.
 - Është krijuar Njësia e projekteve, e cila funksionon pranë Zyrës së kërkimit shkencor dhe në departament. Kjo njësi ka për detyrë të merret me përgatitjen propozimin e

projekteve shkencore, veçse deri tani ajo nuk i ka plotësuar pritshmëritë si pasojë e mosangazhimit të duhur të stafit akademik e të arkitektëve.

- Është ngritur një sistem i referimit vjetor “Mbi punën shkencore të Stafit akademik”, i cili bëhet në fund të vitit akademik përpilohet nga Departamenti dhe arkivohet pranë “Njësisë së brendshme të sigurimit të cilësisë”

b) *Të krijohet mundësia për kualifikimin e personelit të ri akademik si dhe të krijohen mekanizma të qarta dhe transparentë për mbështetjen dhe financimin e aktiviteteve shkencore, në të gjitha njësitë **është plotësuar pjesërisht.***

- Inisiativa për kualifikim të personelit akademik ka mbetur në kuadrin personal të dëshirës për kualifikim, për rrjedhojë të të cilit 3 pjesëtarë të stafit efektiv janë duke ndjekur ciklin e studimeve në doktoraturë. Ndër to 1 pjesëtar i është lejuar ndjekja e doktoraturës në Itali, por pa mbështetje financiare nga Departamenti. (ndihmesa e departamentit kufizohet vetëm në favorizim të largimit të tij të përkohshëm për periudha të shkurtra me anë të lejes institucionale të dhënë pa ndërprerë pagën mujore.)
- Programi i studimit “Master shkencor në Arkitekturë në stafin e tij efektiv PAE ka aktualisht 13 vetë, ndër të cilët vetëm 4 Dr, 0 Prof, 0 Prof.Asoc.;, ndërsa në Stafin Akademik me Kontratë PAK ka 7 vetë, ndër të cilët 4 janë: 2 Prof. Asoc. dhe 2 Dr.
- Thënë kështu rezulton se Departamenti i Arkitekturës, i cili është përgjegjës për këtë program, nuk ka propozuar mobilitete për kualifikim stafi dhe nuk ka mundur të influencojë në planet financiare për të rritur fondin për kualifikim stafi.
- Në zërat Trajnim Safi të AU, ka trajnime në formë leksioni vetëm për aspektin mësimdhënës të procesit mësimor, por duke qenë se studimet në arkitekturë janë të lidhura tërësisht me formimin profesional, ato janë të pamjaftueshme për rritjen e cilësisë së Arkitektit të aktivizuar si mësimdhënës.
- Departamenti duhet të shfrytëzojë më mirë marrëveshje bashkëpunimit që ka me universitetet e huaja me qëllim që në kuadër të tyre të ngrihen projekte të përbashkëta e me financim të përbashkët, të cilat të mundësojnë një zhvillim të Kurrikulave por sidomos të mundësojnë mobilitete të stafit akademik pranë Fakulteteve në Itali, me qëllim kualifikimin e tyre në aspektin profesional e të mësimdhënies.

c) *Të pasurohen më tej laboratorët e materialeve të ndërtimit. **është plotësuar** institucioni nuk ka ngritur një laborator materialesh ndërtimi, por ka lidhur kontratë bashkëpunimi me laboratorin Alb-Consult-2 sh.p.k.*

d) *Të pasurohet biblioteka me literaturë edhe periodikë në fushën e arkitekturës, **është plotësuar pjesërisht.***

- Biblioteka disponon tashmë mjaft tituj mbi arkitekturën, por duhet të pasurojë fondin e periodikëve nga kjo fushë duke qenë se për momentin nuk ka aktiv ndonjë abonim në periodikë në fushën e arkitekturës.

e) *Të shtohen ambientet (përveç 3 ekzistuesve) që pedagogët e brendshëm të punojnë, **është plotësuar** dhe tashmë në Departamentin e Arkitekturës janë 6 zyra të destinuar për Pedagogët.*

f) *Të shtohen përpjekjet dhe vëmendja për informatizimin e sistemit të të dhënave pranë zyrës së burimeve njerëzore për të lehtësuar në procedurë dhe në kohë marrjen e informacionit, përditësimin e tyre dhe më pas përpunimin, **është plotësuar** dhe tashmë në Zyrën e Burimeve Njerëzore baza e të dhënave është në formë elektronike*

- g) Në riorganizimin e kurrikulës që Departamenti po realizon për të aplikuar në vitin akademik 2010 - 2011 të kihet parasysh ulja e numrit të provimeve nga 45 në 35 sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. 15 të datës 04.04.2008, ulja e ngarkesës mësimore për studentët sidomos për vitin e 3-të, **nuk është plotësuar**, ndërkohë që: përcaktimi i krediteve për praktikën mësimore që në kurrikulën ekzistuese është shpërndarë në javën e 15 të secilit semestër, **është plotësuar**.
- Ngarkesa mësimore për studentët vazhdon të mbetet e lartë. Në çdo semestër e në çdo vit akademik ka një numër të lartë provimesh si dhe në total një numër të lartë kreditesh (305). Departamenti duhet të rishikojë kurrikulën me qëllim uljen e numrit të përgjithshëm të krediteve në 300, si dhe vendosjen e një ekuilibri më të mirë midis disiplinave të formimit të përgjithshëm e atyre të formimit karakterizues, në favor të rritjes së peshës së lëndëve të formimit karakterizues.
 - Praktika mësimore nuk zhvillohet më në javën e 15-të por është shpërndarë në lëndë të ndryshme dhe kreditet e saj janë përcaktuar në planin mësimor.
- h) Për zhvillimin e kërkimit shkencor do të ishte hapja e këtij të fundit dhe për publikun, në mënyrë që kërkimi shkencor, aq më tepër në një fushë kaq të aplikuar sa arkitektura dhe urbanistika, të ishte më i prekshëm duke angazhuar edhe specialistë që janë jashtë institucionit për të realizuar kërkim shkencor të aplikuar, **është plotësuar**
- Revista OPTIME është e hapur edhe për publikun duke i mundësuar kujdo botime të artikujve shkencorë në të. Institucioni është hapur ndaj praktikës profesionale duke marrë pjesë në një numër projektesh e konkursesh projektimi.

Përfundimi:

Nga rekomandimet e mësipërme më problematiket mbeten ato të lidhura me cilësinë e kualifikimin e stafit akademik, si dhe me sasinë e cilësinë e kërkimit shkencor, rekomandime të cilat janë plotësuar vetëm pjesërisht. Gjithashtu Pasurimi i Bibliotekës me literaturë e periodikë, sekretaria elektronike dhe ulja e ngarkesës në kredite për studentët, nuk janë plotësuar.

Ndërkohë institucioni ka plotësuar disa nga rekomandimet duke shtuar ambientet për personelin akademik, duke siguruar laboratorin për materialet e ndërtimit, duke përcaktuar në plan mësimor kreditet për praktikën mësimore dhe duke informatizuar bazen e të dhënave të zyrës së burimeve njerëzore.

III. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

- 1) Infrastruktura mësimore e përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve mësimore sipas standardeve.
- 2) Komunikim i mirë dhe i vazhdueshëm Pedagog-Student personalisht por edhe nëpërmjet Zyrës së Karrierës, Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve,
- 3) Komunikimi i mirë me kandidatët për studentë, studentët dhe prindërit përmes faqes së internetit dhe TV UFO Education.

b. Pika të dobëta:

- 1) Mungesa e titujve dhe eksperiencës së gjatë akademike të stafit mësimdhënës
- 2) Mungesa e financimit në kualifikim e specializim të stafit akademik.
- 3) Mungesa e projekteve të përbashkëta që të kontribuojnë në ngritjen e nivelit shkencor të Departamentit.
- 4) Mungesa e të ardhurave nga burime të tjera, të cilat e bëjnë programin e studimit të varur nga tarifat e shkollimit, burim i jashtëm dhe i paqëndrueshëm në vite.
- 5) Mungesa e sekretarisë elektronike të konsultueshme on-line
- 6) Biblioteka me numër të kufizuar titujsh e periodikësh mbi arkitekturën.
- 7) Ndryshimi i shpeshtë i titullarëve dhe lektorëve të lëndëve.
- 8) Ngarkesa përtej normave në disa raste e personelit akademik

c. Mundësitë:

- 1) Aktualisht 4 nga 13 pedagogë të stafit akademik efektiv në Departamentin e Arkitekturës janë duke vijuar studimet e doktoraturës. Ky numër përkon me thujtse 30% të stafit akademik efektiv dhe si i tillë përbën një potencial të mirë për ngritjen e kapaciteteve dhe cilësinë e stafit akademik.
- 2) Kurrikula dhe lëndët specifike që ajo përmban, të mjaftueshme për një formim të plotë të Arkitektit mirëorganizuar por që me rekomandimet e bëra mund të përmirësohet dhe sidomos edhe të rimodelohet për ti dhënë një drejtim specialistik në fushën e arkitekturës.
- 3) Marrëveshjet e bashkëpunimit me universitete të huaja të cilat mund të gjenerojnë projekte me financim të përbashkët me qëllim kualifikimin e stafit akademik.

d. Pengesat:


- 1) Mungesa e stafit të kompletuar me tituj akademikë dhe eksperiencë të gjatë profesionale në fushën e arkitekturës.
- 2) Mungesa e risive në Kurrikulën e programit e cila ofron vetëm një formim bazë të arkitektit.


- 3) Mungesa strategjisë së sjelljes ndaj fenomenit të mungesës së regjistrimeve në program, që në mënyrë pasive justifikohet me rënien e nevojës për arkitektë.

Rekomandime:

- Të rritet numri dhe cilësia e stafit akademik nëpërmjet pajtimit si PAE të profesionistëve me grade/titull shkencor.
- Departamenti i Arkitekturës duhet të shfrytëzojë më mirë marrëveshje bashkëpunimit që ka me universitetet e huaja me qëllim që në kuadër të tyre të ngrihen projekte të përbashkëta e me financim të përbashkët, të cilat të mundësojnë një zhvillim të Kurrikulave por sidomos të mundësojnë mobilitete të stafit akademik pranë Fakulteteve në Itali, me qëllim kualifikimin e tyre në aspektin profesional e te mësimdhënies.
- Të shihet mundësia e riorganizimit të Kurrikulës për të mundësuar formimin në një aspekt më specialistik të arkitekturës, duke e kthyer programin në një faktor konkurrues e të preferuar nga studentët. Kjo do ndihmonte në kthimin e studentëve në kete program, duke qenë se në dy vite ka patur 0 studentë në rregjistrim.
- Departamenti i Arkitekturës dhe Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë”, të cilët merren edhe me monitorimin dhe analizën e kërkimit shkencor, duhet të jenë më aktivë. Nga raportet vjetore mbi kërkimin shkencor dhe ecurinë e mesimdhënies, ata duhet të bëjnë analiza të thelluara dhe të rezultojnë në kërkesa specifike për financim të kualifikimit profesional të stafit efektiv, duke ja drejtuar këto kërkesa instancave drejtuese të AU.
- Të rriten fondet e dhëna nga buxheti i AU në drejtim të kualifikimit të stafit mësimdhënës, duke dhënë bursa specializimi jashtë vendit për të përmirësuar nivelin e tyre profesional e akademik.
- Të organizohet Sekretaria Mesimore në sistem elektronik të konsultueshem on-line për studentët dhe stafin akademik.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


Loreta Çapeli
Dr. Loreta Çapeli


Ledian Bregasi
PhD Ledian Bregasi